



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË**  
**JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KUKËS**



**RAPORTI VJETOR MBI ECURINË E PUNËS SË PROKURORISË PRANË**  
**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**  
**KUKËS PËR VITIN 2023**

**SHKURT 2024**

## **Përmbajtja e lëndës:**

**Abstrakt.....fq.4**

**Hyrje.....fq.5**

### **I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit dhe rekomandimet e rezolutës së Kuvendit për vitin 2023.....fq.7**

- 1.1 Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave/udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- 1.2 Masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave/udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- 1.3 Treguesit dhe indikatorët për rritjen e rolit të prokurorit në hetimet paraprake.
- 1.4 Masat e marra për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprave penale dhe krimit financiar.
- 1.5 Masat e marra në drejtim të respektimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal, të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë apo dëshmitar, grupeve vulnerabël, të pandehur apo viktima, si dhe të veprave penale të dhunës në familje.
- 1.6 Bashkëpunimi ndërinstitucional, analiza të zhvilluara me këto institucione dhe zbatimi i akteve/ marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, KLSH, ILDKPI, BSH, etj.
- 1.7 Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe/ose nëpërmjet prokurorit ndërlidhës shqiptar në EUROJUST.
- 1.8 Specializimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre.

### **II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë.....fq.28**

- 2.1 Volumi i punës në hetim (procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara si dhe vendimet e mosfillimit).
- 2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë.
- 2.3 Treguesit kryesor të punës së prokurorisë (të dhëna statistikore për vendime mosfillimi, procedime pushuar, pezulluar, transferuar, dërguar për gjykim dhe të pandehur/persona nën hetim lidhur me to).
- 2.4 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale, ku të trajtohet si tregues të dhënat për njoftimet/raportimet e qytetarëve për korrupsion.
- 2.5 Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal sipas llojit dhe afatet e kohëzgjatjes së tyre, si dhe numri i personave me masë sigurimi arrest burg/shtëpi ndaj të cilëve është vendosur pushimi i çështjes/akuzës.
- 2.6 Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit pasuror sipas llojit, ku për sekuestrimet të trajtohen llojet dhe vlera e pasurive të sekuestruara e krahasuar me vitin paraardhës.

- 2.7 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku për konfiskimin e pasurive sipas llojeve (konfiskime në procesin penal dhe në procesin/hetimin pasuror sipas ligjit 10192/2009) të trajtohet vlera e pasurive të konfiskuara të krahasuara me vitin paraardhës.
- 2.8 Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të asaj prokurorie.
- 2.9 Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre.
- 2.10 Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje).

### **III. Treguesit statistikorë 2 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së K.Penal....fq.36**

- 3.1 Të dhëna të krahasuara dhe shpjegime lidhur me numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të regjistruar, numrin e të pandehurve dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve dënuar dhe urdhëruar ekzekutimi i tyre.

### **IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë.....rit .....fq.91**

- 4.1 Treguesi i efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale, raporti i çështjeve dhe të pandehurve të dërguara me kërkesë për gjykim me ato të pushuara, dhe raporti i çështjeve të pezulluara me çështjet e përfunduara në hetimet paraprake.
- 4.2 Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve.
- 4.3 Të dhëna për gjykimet e posaçme (numri i procedimeve për të cilat është proceduar me secilin nga llojet e gjykimeve të posaçme, numrin e të pandehurve lidhur me to, vendimarrja e gjykatës).
- 4.4 Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve (kërkesat e prokurorit dhe disponimet e gjykatës).
- 4.5 Të dhëna sociale dhe demografike si për të pandehurit, ashtu dhe për viktimat e veprave penale, si gjinia, mosha, arsimi, punësimi, etj.
- 4.6 Të dhëna për të pandehurit e mitur si: numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të mitur të regjistruar, numrin e të pandehurve të mitur dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve dënuar; numri procedimeve regjistruar, masa sigurimi e dënimi të zbatuara, dënime alternative, etj.
- 4.7 Të dhëna për pasojat e veprave penale.

### **V. Treguesit lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....fq.98**

- 5.1 Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë).
- 5.2 Letërporositë (letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letërporositë për jashtë).
- 5.3 Njohjet e vendimeve penale (njohjet e vendimeve penale të huaja, njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit).

- 5.4 Transferime të procedimeve penale (transferimet e procedimeve nga jashtë, transferimet e cedimeve për jashtë).
- 5.5 Transferime të personave të dënuar (transferimet e personave të dënuar nga jashtë, transferimet e personave të dënuar për jashtë).
- 5.6 Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqiet nga kërkimi ndërkombëtar.

**VI. Të dhëna për ngarkesën dhe treguesit e punës për prokurorët, shefat e sektorit, zëvendësprokurori dhe drejtuesi i prokurorisë.....fq.99**

- 6.1 Të dhëna për ngarkesën e punës për oficer të policisë gjyqësore të seksionit, zbatimi i sistemit elektronik perkatës, dhe të oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat e policive apo agjencive ligjzbatuese përkatëse;

**VII. Informacion mbi administrimin dhe veprimtarinë administrative të prokurorisë si dhe informacion për marrëdhëniet me publikun dhe mediat.....fq.108**

- 7.1 Të dhëna për zbatimin e buxhetit, marrëdhëniet me median dhe publikun, rregullsia e mbajtjes së regjistrave dhe raporteve, mbi zbatimin e CAMS, kapacitetet infrastrukturore dhe siguria, respektimi i disiplinës në punë dhe etikës nga punonjësit.

**VIII. Objektivat sipas drejttimeve prioritare në veprimtarinë administrative dhe funksionale të prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 dhe rekomandime.....fq.110**

## **ABSTRAKT**

*Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës në respektim të detyrimeve ligjore të parashikuara nga neni 50, pika 2 të ligjit Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, pasqyron dhe analizon në raportin vjetor për vitin 2023, treguesit e punës, drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit, të dhënat për numrin, llojin, shtrirjen territoriale, intesitetin dhe format e kriminalitetit, të dhëna të detajuara përsa i pëket efektivitetit të ndjekjes penale si dhe cilësisë së përfaqësimit të akuzës në gjyq, informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, të dhënat për ngarkesën në punë për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore sipas seksionit, të dhënat për administrimin e prokurorisë si dhe të dhëna të tjera, apo problematikat e ndeshura përgjatë vitit 2023. Për punimin e Raportit falenderojmë Kryesekretarin Flamur Çiku dhe specilisten i IT-së Olta Sylja të cilët punuan në bashkëpunim edhe me Drejtuesin e Prokurorisë.*

## **HYRJE**

Ky raport ka si qëllim të paraqesë në mënyrë të detajuar treguesit e punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për vitin 2023. Në tërësi vihet re një ngarkesë e cila në disa drejtime është përballuar nga një staf i reduktuar i prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim si dhe në kryerjen e detyrave të tjera administrativo-penale. Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ka patur ndryshime në strukturën organike si rezultat i bashkimit të Prokurorisë Tropojë me Prokurorinë Kukës<sup>1</sup>, por dhe si rezultat i lëvizjes së prokurorëve për arsye të ndryshme.

Nga data 01.01.2023 deri më datë 01.05.2023 kanë ushtruar detyrën 4 prokurorë: Xhevahir Lita (Drejtuesi i Prokurorisë), Enkeleda Hoxha (zv.Drejtuesi i Prokurorisë), Redona Ndoni (prokuror), ndërsa Griselda Haxhiaj (prokuror) këtë periudhë ka qenë me leje lindje. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kanë ushtruar funksionin 5 oficerë të policisë gjyqësore: Vladimir Shehu, Remzi Duraku, Krenar Lisha, Bledar Xhoxha dhe Nikoleta Marku. Bledar Xhoxha është emëruar oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës me vendimin nr.08, datë 13.01.2023 nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Nikoleta Marku emëruar oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës me vendimin nr.09, datë 13.01.2023 nga Prokuroria e Përgjithshme.

Nga data 01.05.2023<sup>2</sup> deri më datë 31.07.2023 kanë ushtruar detyrën 6 prokurorë: Xhevahir Lita (Drejtuesi i Prokurorisë), Enkeleda Hoxha (zv.Drejtuesi i Prokurorisë), Artan Shtrungza (prokuror), Armida Kaçi (prokuror), Redona Ndoni (prokuror), ndërsa Griselda Haxhiaj (prokuror) këtë periudhë ka qenë me leje lindje. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kanë ushtruar funksionin 6 oficerë të policisë gjyqësore: Vladimir Shehu, Elton Hoxhaj, Remzi Duraku, Krenar Lisha, Bledar Xhoxha dhe Nikoleta Marku.

Nga data 31.07.2023 deri më datë 31.12.2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës kanë ushtruar detyrën 5 prokurorë: Enkeleda Hoxha (Drejtues i Prokurorisë), Artan Shtrungza (prokuror), Armida Kaçi (prokuror), Redona Ndoni (prokuror), ndërsa Griselda Haxhiaj (prokuror). Kanë ushtruar detyrën e oficerit të policisë gjyqësore 6 oficerë të policisë gjyqësore: Vladimir Shehu, Elton Hoxhaj, Remzi Duraku, Krenar Lisha, Bledar Xhoxha dhe Nikoleta Marku.

Pavarësisht këtyre vështirësive dhe problematikave, prokurorëve u është kërkuar në vijimësi zbatimin e drejtë dhe aplikimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe i parashikimeve

---

<sup>1</sup> Me ndryshimet e hartës gjyqësore, udhëzimit nr.1, dt. 26.01.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, ku në nenin 4 të tij parashikohet se nga data 1.5.2023, me nderprerjen e veprimtarisë dhe pushimin së ekzistuarit të strukturave të prokurorisë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Kurbin, Kavajë, Krujë, Lushnje, Mat, Permet, Pogradec, Puke, Tropoje në datën 30.4.2023, prokurorite pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm vazhdojnë funksionimin pranë gjykatave përkatëse, me kompetenca tokësore sipas hartës së re gjyqësore, si më poshte vijojnë: Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me kompetencë tokësore në bashkitë Kukës, Has, Tropojë.

<sup>2</sup> Datë në të cilën është bashkuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës (aktualisht: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës).

ligjore të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, etj. Nga ana tjetër është punuar për hartimin dhe nxjerrjen e rregullave standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë me qëllim sigurimin e një organizimi, drejtimi dhe kontrolli efikas të punës, si dhe rritjen e pavarësisë së prokurorëve dhe nxitjen për kuptimin dhe zbatimin më të mirë të përgjegjësi nga çdo prokuror.

Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Kukës ka funksionuar sipas organikës së përcjellë me shkresën nr. 69/18 prot., dt. 19.01.2023 deri më datë 30.04.2023.

Me ndryshimet e hartës gjyqësore, udhëzimit nr.1, dt. 26.01.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës funksionon sipas hartës së re gjyqësore, duke përthithur Prokurorinë Tropojë. Me shkresën nr. 600/10 prot., datë 24.04.2023 është përcjellë struktura organike, miratuar me Urdhrin nr. 54, dt. 18.04.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm. Në mënyrë të përmbledhur po paraqesim me anë të një table, strukturën para dhe pas hartës së re gjyqësore:

<b>Pozicioni</b>	<b>Organika deri 30.4.2023</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Organika pas 1.05.2023</b>
Drejtues	1	Drejtues	1
Zv. Drejtues	1	Zv. Drejtues	1
Prokuror	3	Prokuror	6
Oficer të policisë gjyqësore	5	Oficer të policisë gjyqësore	6
Kryesekretar	1	Kryesekretar	1
Specialist IT	1	Specialist IT	1
Sekretar pranë prokurorëve	3	Sekretar pranë prokurorëve	3
Koordinator	1	Koordinator	1
Shofer	1	Shofer	1
		Specialist arkivist	1
		Kryetar dege finance	1
		Punonjës shërbimi	1

Aktualisht ngarkesa e punës në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është rritur krahasuar me vitin 2022, ndërkohë që numri i punonjësve të administratës, përmendim këtu pozicionin Sekretar pranë prokurorëve dhe Kryesekretarinë nuk ka ndryshuar.

## **I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT NË VITIN 2023**

Në këtë kre do të pasqyrohen dhe përshkruhen në mënyrë analitike informacioni dhe masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të dala në zbatim të saj. Konkretisht për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, respektimit të të drejtave të njeriut, respektimit të të drejtave të miturve dhe grupeve vulnerabël, si të pandehur dhe viktima, masat e marra për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, masat e marra për rritjen e përdorimit të metodave speciale hetimore dhe në hetimet proaktive.

### **1.1 Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka qenë e angazhuar në marrjen e masave për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në zbatim të tyre, në lidhje me këto prioritete;

- Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë datë 06.07.2023, “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2023”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”.
- Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 10, datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
- Udhëzimi i Përgjithshëm Nr.2/2023 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.
- Plan veprimi “Për zbatimin e Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2023, miratuar më datë 06.07.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm”.
- Plan veprimi “Për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, miratuar me urdhërin nr.70, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Udhëzimeve të përgjithshëm nr.10/2020 dhe 2/2023, rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit dhe planit të veprimit për zbatimin e saj, rekomandimeve prioritare të KM dhe planit të veprimit për zbatimin e tyre, si dhe memorandumit të bashkëpunimit



nr.1079/2,datë 15.07.2020 “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimeve financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe Planit të veprimit ICRG/FATF”.

- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.10/2020 i ndryshuar, në përmbushje të planit të veprimit ICRG/FATF në kuadrin e integritetit evropian të vendit.
- Udhëzimeve të Përgjithshëm nr.5/2018, nr.17/2020 dhe nr.2/2022, rekomandimeve në rezolutën e Kuvendit dhe planit të veprimit për zbatimin e saj, rekomandimeve prioritare të KM dhe planit të veprimit për zbatimin e tyre.
- Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 08 datë 04.12.2019 “Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet ndërmjet tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.
- Udhëzimit nr. 03 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Udhëzimin nr.55 prot datë 10.09.2018 “Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.
- Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.8/2020 datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 6/2021, datë 23.07.2021.
- Udhëzimit të Përgjithshëm me nr. 5/2020 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”.
- Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 10/2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”, i ndryshuar/plotësuar me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 4/2022.
- Udhëzimit të Përgjithshëm nr.8/2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të miturit në konflikt me ligjin, viktimë dhe dëshmitarë”.
- Si dhe akte të tjera të dala në zbatim të tyre.

Drejtuesi i Prokurorisë ka bërë shpërndarjen dhe njohjen e këtyre akteve të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Në vijim në mbledhjet e zhvilluara, mbledhjet e prokurorëve janë diskutuar këto Rekomandime dhe janë orientuar prokurorët dhe oficerët në zbatimin e drejtëpërdrejtë dhe më përparësi të tyre gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje që janë objekt i Rekomandimeve Prioritare.

Gjatë të gjitha mbledhjeve dhe diskutimeve periodike të realizuara është mbajtur parasysh dhe është respektuar pavarësia e institucionit dhe e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në administrimin e materialeve, në kryerjen e hetimeve për çështje të caktuara. Gjithashtu është diskutuar dhe vlerësuar nevoja e nxjerrjes ose jo të urdhërave dhe udhëzimeve të

përgjithshme në lidhje me këto rekomandime dhe është vlerësuar më e drejtë zbatimi i drejtëpërdrejtë nga prokurorët i Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023. Nga ana tjetër, janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime konkrete për çështje të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe është kërkuar informacione në lidhje me çështje konkrete objekt i Rekomandimeve prioritare të cilat është vlerësuar se janë komplekse, janë zvarritur apo nuk janë përfunduar me përparësi nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve.

Masa janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve dhe shpejtësisë e cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara në rekomandimet prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje. Nga ana tjetër është hasur vështirësi në krijimin e grupeve të përbashkëta hetimore me institucionet e tjera, me prokuroritë e tjera apo me autoritetet e huaja për shumë arsye, objektive dhe subjektive dhe në këtë drejtim vlerësoj se duhet një punë e madhe për tu bërë me qëllim realizimin e këtij bashkëpunimi dhe marrjen e rezultateve në kohë reale dhe të vlefshme për të dy palët e këtij bashkëpunimi.

Në fazën e gjykimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posaçme dhe në pasjen parasysh të masave të dënimit të përshtatshme në rastin e çështje objekt të rekomandimeve. Ka një aplikim në rritje përsa i përket institutit të gjykimit me marrëveshje duke krijuar një praktikë të kënaqshme dhe duke shkurtuar fazën e gjykimit të veprave penale. Nga ana tjetër institutet e gjykimit të drejtëpërdretë dhe gjykimit me urdhër penal kanë gjetur një zbatim shumë të kufizuar dhe në këtë drejtim duhet një nxitje më e madhe, ndoshta deri në ndryshime ligjore. Edhe në drejtim të dhënies së dënimeve përsa i përket llojit dhe masës së dënimeve, si dhe në lidhje me dënimet plotësuese apo kërkesat e tjera është bërë një punë e mirë pamvarësisht faktit të mënyrës së vendimarrjes së gjykatës në këto raste.

Gjithashtu, janë zhvilluar mbledhje periodike me prokurorët dhe me oficerët e policisë gjyqësore janë dhënë orientimet e duhura në lidhje me verifikimin e ecurisë së përfundimit të çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve, plotëshmërisë së hetimeve, në respektimin e afateve hetimore, si dhe në respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal. Vlen për tu theksuar se i është vënë theksi edhe në kthimin e përgjigjeve ndaj subjekteve të procedimeve penale (person nën hetim, i pandehur, viktimë, etj) dhe mbrojtësve të tyre brenda afateve ligjore, pasi në disa raste është konstatuar vonesa apo mosrespektim i afateve apo mospranim i kërkesave të palëve të paarsyetuara nga ana e prokurorëve. Në këto raste, u është tërhequr vëmendja dhe janë nxitur prokurorët në respektimin e afateve ligjore dhe në respektimin e të drejtave të këtyre subjekteve.

Gjatë vitit 2023, një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar edhe veprave penale në fushën e krimit të organizuar, si në fushën e narkotikëve (nenet 283/1/2, 283/a/1, 283/a/2, 284,285/a etj).

1. Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal janë mbartur nga viti 2022, 3 procedime penale dhe janë regjistruar 12 procedime

penale gjatë këtij viti. Nga këto 15 procedime në total, 3 prej tyre janë pushuar, 2 janë dërguar në gjyq dhe 10 të tjera janë në fazën e hetimit.

2. Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal është regjistruar vetëm një procedim penal gjatë vitit 2023, i cili është dërguar në gjyq.
3. Për veprën penale “Trafikim i narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/a, prg.1 i Kodit Penal janë mbartur nga viti 2022, 6 procedime penale dhe janë regjistruar 5 procedime penale të reja, në total 11 procedime penale. Nga këto procedime penale 6 janë dërguar në gjyq dhe 5 ndodhen në fazën e hetimeve.
4. Për veprën penale “Trafikim i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a-2 i Kodit Penal është mbartur nga viti 2022, 1 procedim penal dhe janë regjistruar 2 procedime penale të reja gjatë vitit 2023, nga këto 3 procedime penale, 1 procedim penal është pushuar dhe 2 janë në fazën e hetimit.
5. Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotikëve” parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal janë mbartur nga viti 2022, 3 procedime penale dhe janë regjistruar 47 (dyzet e shtatë) procedime penale të reja gjatë vitit 2023. Nga këto procedime penale 1 është pushuar, 15 janë pezulluar dhe 33 ndodhen në fazën e hetimit. Ndërsa për nenin 284/2 është mbartur nga viti 2022 vetëm 1 procedim penal i cili është dërguar në gjyq.

Duhet theksuar që për vitin 2023 ka patur një rritje të konsiderueshme të numrit të procedimeve penale për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike” krahasuar me vitin 2022, ku ka patur 11 procedime penale. Siç shihet nga statistikat kemi një rritje të ndjeshme (4-fishim) të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale, krahasuar me vitin 2022.

Ndërsa për veprën penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a, është regjistruar një procedim penal i cili ndodhet në fazën e hetimit.

Në lidhje me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera për këto vepra penale janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime për oficerët e policisë gjyqësore dhe janë organizuar takime periodike dhe analiza për veprimet e kryera, duke nxitur rritjen e cilësisë së veprimeve të para hetimore, koordinimin e punës me subjektet e tjera dhe institucionet ligjzbatuese dhe kryerjen e veprimeve dhe hetimeve proaktive si dhe paraqitjen e relacioneve më të plota për çështjet e hetuara apo të përfunduara. Në lidhje me këto procedime janë kërkuar informacione periodike, si dhe janë nxjerrë udhëzime për çështje konkrete në varësi të rëndësisë së çështjeve, kompleksitetit, kohës së kaluar në hetim, kërkesës së prokurorit të çështjes apo problematikave të evidentuara rast pas rasti. Gjithmonë është synuar drejt verifikimit të përfundimit të çështjeve, respektimin e afateve procedurale të hetimit dhe të paraburgimit, rritjen e efektivitetit dhe plotëshmërisë së hetimeve dhe respektimit të të drejtave dhe garancive të të gjithë subjekteve të procedimit penal.

Në lidhje me hetimin dhe gjykimin e personave të mitur është caktuar një prokuror për të miturit e cila heton çështjet që i përkasin seksionit me të mitur. Gjithashtu në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është caktuar një oficer i policisë gjyqësore dhe koordinatorja për viktimat e vepës penale dhe çështjet me të mitur qofshin ato të mitur viktimë, në konflikt me ligjin apo dhe si dëshmitar të një veprë penale. Prokurorja dhe oficeri i caktuar janë nxitur dhe orientuar në zbatimin me korrektësi dhe rigorozitet të parashikimeve ligjore dhe procedurale të legjislacionit për të miturit, e në veçanti Kodit të Drejtësisë Penale për të

Miturit. Është synuar në drejtim të respektimit rigoroz të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve. Gjithashtu, është synuar në ndërgjegjësimin e policisë gjyqësore në respektimin e këtyre të drejtave dhe garancive që në fazën e hetimeve të para e në vijim, si dhe gjatë gjykimit të këtyre veprave penale. Vlerësojmë se trajnimi vazhdues i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në lidhje me fushën e miturve do të ndihmojë në rritjen e cilësisë, efektivitetit dhe respektimit më të mirë të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve.

Bashkëpunimi me të gjitha subjektet procedurale dhe trajnimi i tyre me parashikimet ligjore vlerësohet si domosdoshmëri. Gjithashtu, koordinimi më i mirë i punës mes të gjithë faktorëve do të sjellë një hetim më të mirë dhe më të plotë të këtyre veprave penale, duke respektuar gjithmonë detyrimet ligjore dhe të drejtat procedurale të subjekteve të mitur.

Në këtë fushë janë bërë përpjekje dhe është rakorduar edhe me prokuroritë e tjera në lidhje me procedimet penale me të mitur, duke i njohur me parashikimet dhe detyrimet ligjore që pranë çdo prokurorie të krijohet dhe të funksionojë seksioni për të miturit dhe në pamundësi të caktohet një prokuror për të miturit në zbatim të parashikimeve ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

Gjatë këtij viti, është nxitur bashkëpunimi i ngushtë dhe efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Prokurori, kryesisht me institucionet ligjzbatuese që operojnë në Qarkun Kukës, si me Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, Komisariateve të Policisë Kukës, Tropojë dhe Has, me Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Shërbimin Informativ të Shtetit, me Seksionin e Sigurisë së Autostradës Milot-Morinë, me Agjencinë e Mbikqyrjes Policore, si dhe me Drejtorinë e Doganës Morinë, ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit. Gjithashtu, vijnë hetimet për një sërë procedimesh penale të referuara nga këto institucione në bashkëpunim mes këtyre shërbimeve të policisë gjyqësore. Nga ana tjetër vlerësojmë se organizimi i seminareve dhe trajnimeve si të prokurorëve ashtu edhe të oficerëve të policisë gjyqësore në fushën e veprave penale objekt i rekomandimeve prioritare vlerësohet i domosdoshëm me qëllim kryerjen e hetimeve të shpejta, të plota, efektive dhe cilësore dhe garantimin e të drejtave të këtyre subjekteve.

Sa i përket Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 03 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” për hedhjen e shortit elektronik në periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë marrë masa për respektimin e këtij udhëzimi. Është bërë hedhja e shortit elektronik për të gjitha kallëzimet penale. Është treguar kujdes në rastet e marrjes së vendimeve për përjashtim nga shorti të prokurorëve të caktuar, duke u nisur nga ngarkesa e tyre si dhe në rastet me raport mjekësorë. Ndërsa për çështjet e vjetra, të rifilluara, të kthyera nga gjykata dhe kur është bërë zëvendësimi i prokurorit apo heqja dorë është aplikuar shorti manual për shkak të pamundësisë së hedhjes së shortit elektronik. Në rastet e çështjeve me të mitur i janë caktuar direkt prokuores e cila merret me hetimin e çështjeve me të mitur.

Udhëzimi i Përgjithshëm nr.8/2020 datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” i ndryshuar me udhëzimin nr. 06/2021 datë 23.07.2021, ku në nenin 36 të ndryshuar të udhëzimit parashikohet raportimi periodikisht i shpenzimeve procedurale nga zyrat e financës në secilën prokurori. Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë kryer 5.344.354 lekë

shpenzime në total për vitin 2023, të ndara sipas zërave përkatës. Konkretisht shpenzime për përkthyesit gjatë vitit 2023 janë në vlerën 384.454 lekë, shpenzime për avokatët 618.000 lekë, shpenzime për ekspertët 3.829.900 lekë dhe shpenzime për shërbimet e marra nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) janë në vlerën 512.000.

Udhëzimi i Përgjithshëm nr.05/2020 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës” për të siguruar konsulta teknike dhe asistencë apo këshillime mbi kërkesat e prokurorëve, për procedime apo çështje penale në fushat ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale auditimi të brendshëm publik në fushat inxhinierike – mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore, janë kryer shpenzime të ekspertizës në vlerën 3.829.900 lekë. Problematikë për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka qenë mungesa e një eksperti mjeko-ligjor dhe për këtë fakt kemi qenë të detyruar të transportojmë të dëmtuarit apo viktimën për në Institutin e Policisë Shkencore Tiranë apo dhe në morgun pranë spitalit QSUT Tiranë. Po ashtu kjo mungesë passjell që edhe aktet e ekspertimit mjekoligjor të kryhen pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, duke sjellë vonesa në përfundimin e hetimeve, për shkak të ngarkesës së punës së institutit.

## **1.2 Masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshilit të Ministrave dhe urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në bazë të tyre.**

Menjëherë me marrjen dhe administrimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2023”, datë 06.07.2023 si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.103, datë 25.07.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është bërë punimi dhe njohja e këtyre akteve për të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të kësaj prokurorie. Në vijim në mbledhjet e zhvilluara, takimet dhe udhëzimet e dhëna janë diskutuar pikat e kësaj Rezolute dhe janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në zbatimin e drejtëpërdrejtë të saj gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje konkrete që janë objekt dhe prioritet i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Në mbledhjet, diskutimet e realizuara dhe udhëzimet e dhëna në vijim është mbajtur parasysh dhe është respektuar pavarësia e institucionit dhe e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale si dhe në administrimin e materialeve hetimore e referuese në kryerjen e hetimeve për çështje të caktuara. Gjatë këtyre mbledhjeve dhe diskutimeve është vlerësuar nevoja e nxjerrjes ose jo të urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme apo të një plani veprimi në lidhje me Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë. Për këtë arsye, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është punuar Udhëzimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023” ku në vijim ky udhëzim u është bërë i njohur dhe ju është shpërndarë nga një kopje të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës, duke u diskutuar edhe në mbledhjet dhe takimet e organizuara.

Ju është kërkuar prokurorëve që të garantojnë pavarësinë e tyre nga njëra anë dhe rritjen e përgjegjshmërisë së tyre nga ana tjetër. Gjithashtu janë nxitur në forcimin e rolit të tyre në fillimin e ndjekjes penale dhe forcimin e rolit aktiv në hetimet paraprake dhe në fillimin kryesisht të ndjekjes penale. Në vijim janë udhëzuar prokurorët për kontrollin periodik dhe efektiv të punës së oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës në lidhje me dosjet e deleguara prej tyre, me qëllim kryerjen e hetimeve të plota dhe cilësore si dhe shmangien e vonesave apo zvarritjeve në përfundimin e hetimeve.

Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore u është kërkuar të angazhohen drejtëpërdrejtë në rritjen e tyre profesionale, në plotësimin e formularëve për trajnime dhe seminare dhe për pjesëmarrjen fizike të tyre ose online në trajnimet e realizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë dhe shoqatat e organizatat vendase dhe të huaja duke respektuar edhe fushat specifike ku ata kanë më shumë nevojë apo në raport me seksionet ku ata bëjnë pjesë. Nga Drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar informacion në lidhje me çështje konkrete që janë objekt i Rezolutës së Kuvendit. Në rastet kur është vlerësuar se këto detyra dhe objektiva në procedimet penale konkrete janë komplekse, ka zvarritje apo vonesa dhe nuk janë përfunduar me përparësi nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve konkrete është udhëzuar dhe rekomanduar kryerja me prioritet e detyrave të lëna. Në disa raste janë nxjerrë edhe udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete të cilat janë vlerësuar të domosdoshme apo rastet prioritet i Rezolutës së Kuvendit.

Në zbatim të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.164, datë 18.12.2020 “Për miratimin e rregulloreve standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”, nga Drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar zbatimi i rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Gjithashtu janë marrë masa për shpërndarjen dhe njohjen e saj për prokurorët, oficerët dhe nëpunësit e tjetër të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe marrjen e masave për zbatimin e këtyre ndryshimeve gjatë punës në Prokurori.

Në vijim të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.164, datë 14.12.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” nga Drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar zbatimi dhe rregullimi i marrëdhënieve mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Masa konkrete janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve dhe shpejtësisë dhe cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara në rekomandimet prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje. Në fazën e gjykimit janë

orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posaçme dhe në pasjen parasysh të masave të dënimit të përshtatshme në rastin e çështjeve objekt të Rezolutës.

Janë marrë masa dhe janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime edhe për oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera prej tyre, në lidhje me raportimet periodike për veprimet e kryera, si dhe për rritjen e cilësisë së relacioneve të çështjeve të përfunduara dhe shpejtësisë së përfundimit të tyre.

Gjatë vitit 2023 është nxitur bashkëpunimi i ngushtë dhe efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Prokurori, kryesisht me institucionet ligjzbatuese që operojnë në Qarkun Kukës, si me Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, Komisariateve të Policisë Kukës, Tropojë dhe Has, me Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Shërbimin Informativ të Shtetit, me Seksionin e Sigurisë së Autostradës Milot-Morinë, me Agjencinë e Mbikqyrjes Policore, si dhe me Drejtorinë e Doganës Morinë, ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit. Gjithashtu, vijojnë hetimet për një sërë procedimesh penale të referuara nga këto institucione në bashkëpunim mes këtyre shërbimeve të policisë gjyqësore.

Është synuar në zbatimin e masave të gjëra të shortit elektronik për çdo referim apo kallzim që vjen në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Shorti elektronik ka qenë shumë i rregullt dhe pa problematika, theksojmë që të gjitha materialet hetimore, referime apo kallzime shortohen elektronikisht në mënyrë të barabartë midis prokurorëve që ushtrojnë funksionin në Prokurorinë Kukës. Përrjashtim nga shorti elektronik bëjnë vetëm rastet e arresteve që i kalojnë direkt prokurorit të gadshëm i cili kryen dhe hetimet paraprake, si dhe çështjet me të mitur të cilat i kalojnë direkt prokurorit të caktuar me urdhër për çështjet me të mitur (të mitur viktimë/dëshmitar dhe në konflikt me ligjin). Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është përdorur shorti manual në disa raste. Në rastet e zëvendësimit, pezullimit nga detyra apo transferimit të prokurorëve të gjitha dosjet hetimore të prokurorëve të larguar, pezulluar apo transferuar në një prokurori tjetër shortohen manualisht midis prokurorëve të tjerë, ku dosjet ndahen në mënyrë të barabartë me procesverbal-et përkatëse dhe në prani të gjithë prokurorëve midis të cilëve shortohen dosjet. Rast tjetër është për dosjet që rifillojnë hetimet apo rastet e pezullimeve kur ka zhvillime të reja hetimore dhe prokurorët e këtyre çështjeve nuk ushtrojnë më funksionin në prokurori këto dosje shortohen manualisht, apo parashkrimet të cilat shortohen manualisht në mënyrë të barabartë midis prokurorëve, si dhe letërporositë që vijnë nga jashtë shtetit, kërkesat e njohjeve të vendimeve penale të huaja shortohen manualisht dhe shoqërohen me procesverbalet përkatëse. Një kopje procesverbali mbahet në Kryesekretari, një e mban specialist i IT-së dhe një prokurori bashkë me dosjet përkatëse të rena nga shorti manual. Përrjashtuar këto raste ku dosjet shortohen manualisht, për rastet e tjera është mbajtur në funksion sistemi elektronik i ndarjes dhe menaxhimit të çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), duke bërë pasqyrimin e saktë në sistem të shortit. Në lidhje me sistemin CAMS nuk ka patur problematika për ndarjen e materialeve kallëzuese. Materialet kallëzuese nga data

03.05.2023 që përkon me bashkimin e Prokurorisë Tropojë me Prokurorinë Kukës, në bazë të urdhërit nr.11 datë 03.05.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë Kukës, është bërë ndarja në seksione<sup>3</sup> dhe shorti elektronik është bërë në bazë të seksioneve.

Një vëmendje e veçantë, i është kushtuar dhe bashkimit të Prokurorisë Tropojë me Prokurorinë Kukës, e cila përveç udhëzimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme është shoqëruar me një sërë urdhrash të brendshëm të nxjerra nga drejtuesi i Prokurorisë Kukës, për mbarëvajtjen e punës. Këtu përmendim urdhërin nr.11 datë 03.05.2023 “Për ndarjen e seksioneve në Prokurorinë Kukës”, urdhrin nr.14 datë 09.05.2023 për ndryshimin e shkresave, urdhri nr. 14/1 datë 09.05.2023 në lidhje me dosjet penale të Prokurorisë Tropojë, urdhër nr.20 datë 01.06.2023 “Për riorganizimin e seksioneve”.

### **1.3 Treguesit dhe indikatorët për rritjen e rolit të prokurorit në hetimet paraprake.**

Gjatë vitit 2023, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në lidhje me veprat penale të rënda, ato me ndjeshmëri të lartë shoqërore apo me interes për publikun janë nxitur dhe udhëzuar prokurorët dhe oficerët në kryerjen e hetimeve të plota dhe të thelluara, me qëllim hetimin e plotë të çështjeve penale konkrete apo në zbulimin dhe identifikimin formave të bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e veprimtarisë kriminale.

Përsa i përket veprës penale të korrupsionit, konkretisht në lidhje me veprën penale “Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, veprën penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, për vitin 2023 nuk kemi patur procedime penale të regjistruar në Prokurorinë Kukës dhe asnjë procedim penal të mbartur nga vitet e mëparshme.

Për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal janë regjistruar 13 procedime penale të reja dhe 8 të mbartura nga viti i mëparshëm. Nga këto 21 procedime penale, 2 prej tyre janë transferuar në Ministrinë e Drejtësisë për tu transferuar në Republikën e Kosovës, 3 janë pushuar, 2 janë dërguar në gjyq, dhe 14 procedime penale janë në fazën e hetimit.

Gjatë këtij viti, një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar edhe veprave penale në fushën e narkotikëve (nenet 283, 283/a, 284, etj) që duhet theksuar që ka patur një numër të konsiderueshëm procedimesh penale në fushën e narkotikëve.

- a. Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal janë mbartur nga viti 2022, 3 procedime penale dhe janë regjistruar 12 procedime penale gjatë këtij viti. Nga këto 15 procedime në total, 3 prej tyre janë pushuar, 2 janë dërguar në gjyq dhe 10 të tjera janë në fazën e hetimit.
- b. Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal është regjistruar vetëm një procedim penal gjatë vitit 2023, i cili është dërguar në gjyq.
- c. Për veprën penale “Trafikim i narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/a, prg.1 i Kodit Penal janë mbartur nga viti 2022, 6 procedime penale dhe janë regjistruar 5

---

<sup>3</sup> Urdhri nr.11, datë 03.05.2023 “Për ndarjen e seksioneve në Prokurorinë Kukës”, i ndryshuar.




procedime penale të reja, në total 11 procedime penale. Nga këto procedime penale 6 janë dërguar në gjyq dhe 5 ndodhen në fazën e hetimeve.

- d. Për veprën penale “Trafikim i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a-2 i Kodit Penal është mbartur nga viti 2022, 1 procedim penal dhe janë regjistruar 2 procedime penale të reja gjatë vitit 2023, nga këto 3 procedime penale, 1 procedim penal është pushuar dhe 2 janë në fazën e hetimit.
- e. Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotikëve” parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal janë mbartur nga viti 2022, 3 procedime penale dhe janë regjistruar 47 (dyzet e shtatë) procedime penale të reja gjatë vitit 2023. Nga këto procedime penale 1 është pushuar, 15 janë pezulluar dhe 33 ndodhen në fazën e hetimit. Ndërsa për nenin 284/2 është mbartur nga viti 2022 vetëm 1 procedim penal i cili është dërguar në gjyq.

Duhet theksuar që për vitin 2023 ka patur një **rritje** të konsiderueshme të numrit të procedimeve penale për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike” krahasuar me vitin 2022, ku ka patur 11 procedime penale. Siç shihet nga statistikat kemi një rritje të ndjeshme (4-fishim) të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale, krahasuar me vitin 2022 (dhe me vitet e mëparshme 2022, 2021, 2020)

Pjesa më e madhe e këtyre kallëzimeve ka ardhur nga Komisariati i Policisë Tropojë dhe zonat e kultivimit të narkotikëve janë në qytetin e Tropojës. Në këto raste ka qenë dhe e vështirë identifikimi i autorëve të kultivimit të narkotikëve për shkak të terrenit shumë të vështirë.

Për me tepër shohim grafikun e mëposhtëm i cili tregon rritjen e numrit të procedimeve për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284, krahasuar me 3 vitet e mëparshme.



**Figura 1:** Kultivimi i narkotikëve ndër vite (2020-2023)

Në lidhje me këto grup veprash janë udhëzuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së hetimeve (realizimin e hetimeve proaktive), kryerjen e hetimeve të shpejta, si dhe përdorimin e metodave speciale të hetimit, bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe agjencitë ligjzbatuese në realizimin e hetimeve sa më të plota, si dhe në ashpërsimin e qëndrimeve e të politikës penale si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në masën e dënimeve.

Në lidhje me veprat penale në fushën e trafikimit, për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, për sa i përket nenit 298/1 janë mbartur 4 procedime penale dhe janë regjistruar 4 procedime penale të reja, nga këto 8 procedime penale 1 është pushuar, 1 është transferuar, 1 është dërguar në gjyq, 2 janë pezulluar dhe 3 ndodhen në fazën e hetimit.

Për nenin 298/2 janë mbartur 3 procedime penale dhe janë regjistruar 3 procedime penale të reja për vitin 2023, nga këto 6 procedime penale të gjitha janë dërguar në gjyq.

Për nenin 298/3 janë mbartur 3 procedime penale nga viti 2022, të cilat 2 janë dërguar në gjyq dhe 1 procedim penal është transferuar.

Në lidhje me veprat penale që lidhen me krimet financiare kemi patur disa raste sipas neneve të mëposhtme:

1. Për sa i përket veprës penale “Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës” parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal për vitin 2023 janë regjistruar 5 procedime penale, nga të cilat 4 për nenin 172 dhe 1 procedim penal parashikuar nga neni 172/1. Nga këto 5 procedime penale procedim penal është dërguar për gjykim dhe 4 procedime penale janë në fazën e hetimit.
2. Për veprën penale “Kontrabandë me mallrat e tjera”, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal janë mbartur 3 procedime penale dhe janë regjistruar 4 procedime penale gjatë këtij viti, nga të cilat 2 janë transferuar, 3 janë dërguar në gjyq dhe 2 janë në fazën e hetimit.
3. Për veprën penale “Mosdeklarim në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë”, parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal, është mbartur 1 procedim penal nga viti i kaluar dhe janë regjistruar 13 procedime penale për vitin 2023, në total 14 procedime penale nga të cilat 12 procedime penale janë dërguar në gjyq dhe 2 procedime penale janë në fazën e hetimeve.
4. Për veprën penale “Moslëshim i kuponit tatimor”, parashikuar nga neni 180/1, janë mbartur 2 procedime penale nga viti i mëparshëm dhe është regjistruar 1 procedim penal, nga të cilat 2 procedime penale janë pushuar dhe 1 ndodhet në fazën e hetimit.
5. Për veprën penale “Fshehja e të ardhurave” parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, i cili është dërguar në gjyq.
6. Për veprën penale “Ushttrim i aktivitetit të paligjshëm” parashikuar nga neni 180/a-2 është regjistruar 1 procedim penal i cili është pushuar me kërkesë për pushim.
7. Për veprën penale “Fallsifikim i monedhave” parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, i cili është transferuar në Prokurorinë Lezhë.

Gjatë vitit 2023, nuk janë regjistruar hetime pasurore të reja, përveç atyre të regjistruara në vitet e mëparshme, nga të cilat një procedim pasuror konkretisht procedimi pasuror nr.10 regjistruar

në vitin 2022 është bërë ndarja e këtij procedimi pasuror në 10 procedime pasurore, me vendim ndarje të procedimit pasuror të datës 08.05.2023. Nga këto 10 procedime pasurore një procedim pasuror nr. 10/7 është transferuar për moskompetencë në SPAK, ndërsa të tjerat ndodhen në fazën e hetimeve në bazë të ligjit antimafia.

Gjithashtu 1 procedim pasuror (procedimi pasuror nr.03/2022, regjistruar në Prokurorinë Tropojë), është transferuar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës më datë 05.06.2023.

Gjatë vitit 2023, për procedimin pasuror nr.09/2022 është bërë 1 kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror, më datë 16.11.2023 e cila me vendimin nr.176, datë 20.11.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është pranuar kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit pasuror.

- ❖ Përsa i përket veprës penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, janë regjistruar 2 procedime penale për vitin 2023, të cilat janë akoma në fazën e hetimit. Gjithashtu është rifilluar një dosje e vitit 2020, konkretisht procedimi penal 259/1 e vitit 2020 për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, e cila është pezulluar me datë 20.04.2023 në pritje të të dhënave nga autoritetet e huaja.

Përsa i përket procedimeve penale të hetuara me metoda speciale të hetimit (përgjime) janë hetuar me metoda speciale të hetimit 14 procedime penale për vitin 2023, duke zhvilluar hetime proaktive (përgjime ambjentale dhe telefonike, vëzhgime, blerje e simuluar, e metoda të tjera speciale, etj), kryesisht në lidhje me vepra të rënda penale kundër jetës dhe shëndetit, në lidhje me narkotikët (prodhim, shitje, trafikim, kultivim), në lidhje me shpërdorimin e detyrës dhe në lidhje me trafikimin e personave apo shfrytëzimin e prostitucionit, etj. Theksojmë se nga këto 14 procedime penale disa prej tyre kanë pasur dhe zgjatje afatesh përgjimi telefonik apo raste kur për një procedim penal janë bërë disa kërkesa/vendime për lejim përgjimi telefonik. Në një pjesë të tyre këto veprime hetimore kanë dhënë rezultate të kënaqshme dhe në plotësimin e hetimeve, një pjesë e këtyre procedimeve janë dërguar për gjykim me akuzat përkatëse, ndërsa pjesa tjetër vijon të jetë në hetim.

Në lidhje me krimin kibernetik për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për nenin 186/1, janë mbartur 4 procedime penale nga viti i kaluar dhe janë regjistruar 6 procedime penale të reja, si dhe është rifilluar një procedim i pezulluar, nga këto 11 procedime penale 4 procedime penale janë pushuar, 1 është pezulluar, 5 procedime penale janë dërguar në gjyq dhe 1 ndodhet në fazën e hetimit. Për nenin 186/2 është mbartur 1 procedim penal nga viti i kaluar i cili ndodhet në fazën e hetimit.

Në lidhje me veprën penale “Falsifikim kompjuterik” parashikuar nga neni 186/a-1 i Kodit Penal është mbartur 1 procedim penal nga viti 2022 dhe është regjistruar 1 procedim penal i ri, nga këto 2 procedime penale, 1 është transferuar dhe 1 ndodhet në fazën e hetimit.

Përsa i përket veprës penale “Ndërhyrje në të dhënat kompjuterike” parashikuar nga neni 293/b/1 i Kodit Penal janë mbartur 2 procedime penale nga viti 2022 dhe është regjistruar 1 procedim penal, nga këto 3 procedime penale 1 është pezulluar dhe 2 ndodhen në fazën e hetimit.

Për veprat penale në fushën e zgjedhjeve nenet 325 – 332/a të Kodit Penal është regjistruar vetëm 1 procedim penal për veprën penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” parashikuar nga neni 329/1 i cili është pushuar.

Për veprat penale kundër mjedisit të parashikuara nga nenet 201-207 të Kodit Penal janë regjistruar të dhënat si më poshtë:

1. Për veprën penale “Shkatërrim prone me zjarr” parashikuar nga neni 201/a i Kodit Penal është regjistruar 1 (një) procedim penal i cili është në fazën e hetimit.
2. Për veprën penale “Transportimi i mbeturinave toksike” parashikuar nga neni 202/b i Kodit Penal është regjistruar 1 (një) procedim penal i cili është në fazën e hetimit.
3. Për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal janë mbartur 6 procedime penale, 1 procedim penal i pezulluar është bërë rifillim dhe janë regjistruar gjithsej 13 procedime penale nga të reja nga këto 20 procedime penale në total, 2 procedime penale janë transferuar, 2 procedime penale janë pushuar, 3 procedime penal janë dërguar në gjyq, 5 procedime penale janë pezulluar dhe 8 procedime penale janë ende në fazën e hetimit.
4. Për veprën penale “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” parashikuar nga neni 206 i Kodit Penal janë rifilluar 2 procedime penale të cilat kanë qenë të pezulluara, ku të dy këto procedime penale janë pushuar.
5. Për veprën penale “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” parashikuar nga neni 207/b i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, i cili ndodhet në hetim.

Në lidhje me veprat penale të përfshira në krimet seksuale përkatësisht parashikuar nga nenet 100-108 a/2 të Kodit Penal në Prokurorinë Kukës janë regjistruar të dhënat si më poshtë:

Për veprën penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur” parashikuar nga neni 101/22 i Kodit Penal, gjatë vitit 2023 është regjistruar 1 procedim penal, i cili është dërguar në gjyq me dy të pandehur. Ky procedim penal është i mbartur nga viti 2022 dhe kërkesa për gjyq është bërë me datë 11.09.2023, ndodhet para gjyqtarit të Seancës Paraprake.

Për veprën penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura” parashikuar nga neni 102/1 i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, i cili ndodhet në fazën e hetimeve.

Për veprën penale “Ngacmimi seksual” parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal është regjistruar 2 procedime penal të cilat ndodhen në fazën e hetimeve.

#### **1.4 Masat e marra për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprave penale dhe krimit financiar.**

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar veprës penale “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal si dhe hetimeve të referimeve/procedimeve pasurore bazuar në Ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Përsa i përket veprës penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, janë regjistruar 2 procedime penale për vitin 2023, të cilat janë akoma në fazën e hetimit.

Gjithashtu është rifilluar 1 procedim penal i vitit 2020, konkretisht procedimi penal 259/1 i vitit 2020 për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, e cila është pezulluar me datë 20.04.2023 në pritje të të dhënave nga autoritetet e huaja. Procedimi penal nr. 49/2022 i regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë në vitin 2022 është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me datë 05.06.2023.

Gjatë vitit 2023, nuk janë regjistruar hetime pasurore të reja, përveç atyre të regjistruar në vitet e mëparshme, por procedimi pasuror nr.10 i regjistruar në vitin 2022 është ndarë në 10 procedime pasurore me vendim ndarje procedimi pasuror me datë 08.05.2023. Nga këto 10 procedime pasurore, 1 procedim pasuror nr.10/7 është transferuar për moskompetencë në SPAK, ndërsa procedimet e tjera ndodhen në fazën e hetimeve në bazë të ligjit antimafia. Gjithashtu gjatë këtij viti, 1 procedim pasuror konkretisht, procedimi pasuror nr.03/2022, regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë, është transferuar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me datë 05.06.2023.

- ❖ Gjatë vitit 2023, për procedimin pasuror nr.09/2022 është bërë kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror, më datë 16.11.2023 dhe me vendimin nr.176, datë 20.11.2023 Gjykata pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka pranuar kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit pasuror ndaj disa pasurive të subjektit të hetimit dhe personave të tij të lidhur.

Duhet theksuar se një pjesë e madhe e procedimeve pasurore janë në hetim, për shkak të numrit të lartë të veprimeve hetimore si dhe volumit që kanë si dosje hetimore. Pjesa më e madhe e këtyre dosjeve janë të mbartura nga vitet e kaluara dhe janë të shpërndarë te të gjithë prokurorët. Vitet e mëparshme nuk kemi patur prokuror të caktuar apo seksion që të merrej me hetimin e të gjithë referimeve/procedimeve pasurore, fakt që do kishte ndihmuar në përshpejtimin dhe në përmirësimin e hetimeve për dosjet hetimore që hetohen bazuar në Ligjin Antimafia.

Vlerësojmë se zhvillimi apo shtimi i trajnimeve në fushën e “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” apo publikimi i një manuali për hetimin e këtyre veprave penale do të sillte një përmirësim të dukshëm të mënyrës së hetimit apo cilësisë së hetimit të kësaj vepre penale. Drejtuesi i Prokurorisë në vijimësi u ka sugjeruar prokurorit të caktuar për hetimet pasurore dhe oficerëve të policisë gjyqësore që të plotësojnë formularët e trajnimeve

vazhduese duke zgjedhur tema në lidhje me këtë vepër penale në mënyrë që të marrin trajnime dhe njohuri e duhura me metodat dhe praktikat e reja më të mira të hetimit.

### **1.5 Masat e marra në drejtim të respektimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal, të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë apo dëshmitar, grupeve vulnerabël, të pandehur apo viktima, si dhe të veprave penale të dhunës në familje.**

Në zbatim të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2023”, datë 06.07.2023, si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit për vitin 2023”, si dhe të udhëzimit Nr.5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, në vijimësi janë organizuar mbledhje e diskutime dhe janë dhënë udhëzime jo vetëm me njohjen me këto akte por, edhe me zbatimin në praktikë të udhëzimit dhe dhënies së asistencës dhe mbështetjes së viktimave të veprës penale apo edhe dëshmitarëve. Në lidhje me këtë udhëzim janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe psikologët dhe koordinatorja e viktimave në dhënien e asistencës, këshillimit dhe ndihmës ligjore dhe psikologjike gjatë kontakteve, pyetjeve dhe në intervistimet me viktimat e këtyre veprave por edhe në rastin e personave nën hetim apo të pandehurve të mitur, etj.

Në këtë drejtim vlerësoj se seksioni për të miturit me një prokuror dhe një oficer si dhe me stafin ndihmës kanë bërë një punë të mirë në drejtim të orientimit dhe ndërgjegjësimin të subjekteve të tjera procedurale, si dhe në rritjen e bashkëpunimit me subjektet e tjera procedurale, me strukturat përkatëse pranë bashkive si dhe me shoqatat e mbrojtjes së viktimave të veprave penale, të dhunës në familje apo Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në procesin penal, si dhe e grupeve të tjera vulnerabël ka qenë dhe mbetet një sfidë për tu realizuar. Parashikimet e ligjit nr.37, viti 2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, kanë nxjerrë detyra dhe problematika të reja për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Implementimi i plotë i këtij ligji, i akteve të tjera dhe institucioneve të reja mbetet një sfidë për tu realizuar dhe duhet pranuar që në këtë drejtim po punohet me seriozitet por, përsëri mbetet shumë për tu bërë nga të gjitha palët.

Në vijimësi, janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët dhe oficerët jo vetëm në zbatimin e parashikimeve ligjore, por edhe në zbatimin dhe përqëndrimin në urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm “Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur person nën hetim, i dëmtuar, viktimë e vepres penale ose edhe si dëshmitar”, duke siguruar pjesëmarrjen e psikologut gjatë hetimit, si asistues i të miturit ashtu edhe në kryerjen e raportit psikologjik për të miturin gjatë hetimeve. Po ashtu janë orientuar oficerët e policisë gjyqësore në drejtim të ruajtjes së sekretit të informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore dhe provave të mbledhura nga policia gjyqësore, në rastet e hetimeve në ngarkim të pandehurve të mitur.

Gjatë këtij viti janë rregjistruar 49 (dyzet e nëntë) referime penale me të mitur. Nga këto 19 referime janë bërë mosfillime, ku në 6 prej tyre është zbatuar shmangia nga përgjegjësia penale ndërsa 13 referime janë mosfilluar për shkaqe të tjera, si mosha etj.

Përsa i përket procedimeve penale me të mitur janë regjistruar 30 procedime penale, nga të cilat 15 procedime penale janë pushuar (14 prej tyre është aplikuar shmangie paralajmërim me shkrim dhe 1 rast është pushuar për shkaqe të tjera), janë transferuar 4 procedime penale dhe 2 procedime penale janë dërguar në gjyq. Ndodhen në fazën e hetimit 9 procedime penale me të mitur. Në të gjitha rastet është synuar shmangia e masës së sigurimit “Arrest në burg” për personat e mitur në konflikt me ligjin pasi, vetëm një person rezulton përsëritës, dhe është vendosur masë sigurimi “Vendosja në mbikqyrje e të miturit ” sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Në procedimet me të mitur në të gjitha rastet është realizuar pyetja apo kryerja e veprimeve të tjera hetimore në prani të psikologut, të përfaqësuesit ligjor dhe të mbrojtësit të zgjedhur apo të caktuar kryesisht. Në këto procedime si dhe ato me të mitur viktimë të veprës penale janë marrë vendimet për kryerjen e raporteve të vlerësimit psikologjik dhe janë administruar raportet përkatëse nga ekspertët psikologë apo specialistët e ZVSHP para përfundimit të hetimeve dhe marrjes së vendimit përfundimtar për shmangie, për pushim apo për dërgimin në gjykim të çështjes.

Asistenca e duhur ndaj grave të dhunuara, të miturve dhe viktimave të tjera të veprave penale është arritur edhe në sajë të bashkëpunimit me institucionet e tjera, me shoqatat dhe në sajë të marrëveshjeve me drejtoritë përkatëse të krijuara pranë Bashkive. Është synuar në drejtim të kryerjes së veprimeve hetimore duke shmangur riviktimizimin e tyre, krijimin e një ambjenti të përshtatshëm gjatë marrjes në pyetje apo kryerjes së veprimeve të tjera dhe shmangien e ripyetjeve të tyre për aq sa ka qenë e mundur.

Gjithashtu, është kërkuar kryerja e veprimeve të shpejta hetimore në rastin e hetimeve me persona të mitur të dyshuar por edhe në rastet kur kanë qenë në pozitën e viktimave të veprës penale. Duhet thënë që pjesa më e madhe e procedimeve janë përfunduar në afate të shkurtra 1-2 ose 3 mujore duke respektuar detyrimet ligjore përkatëse të K.Pr.Penale dhe K.D.P.M.

Në lidhje me hetimin dhe gjykimin e personave të mitur qoftë si persona nën hetim, si të pandehur, ashtu edhe si viktimat të veprës penale është synuar gjithmonë në drejtim të respektimit të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve, duke respektuar të gjitha garancitë e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore. Janë nxitur dhe orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në ndërgjegjësimin e tyre në drejtim të respektimit të këtyre të drejtave dhe ofrimit të të gjitha garancive ligjore që në fazën e hetimeve të para e në vijim, si dhe gjatë gjyqimit të këtyre veprave penale.

Në lidhje me veprën penale më të përhapur përsa i përket këtyre grupveprave, vepra penale e “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, gjatë këtij viti për nenin 130/a-1 janë mbartur 5 procedime penale nga viti i kaluar dhe janë regjistruar 19 procedime penale për vitin 2023. Nga këto 24 procedime penale 5 prej tyre janë pushuar, 2 janë transferuar, 11 janë dërguar në gjyq dhe 6 janë akoma në fazën e hetimit.

Për veprën penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a-2 i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal i cili është dërguar në gjyq.

Për veprën penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a-4 i Kodit Penal janë regjistruar 2 procedime penale gjatë këtij viti nga të cilat 1 është transferuar dhe një është në fazën e hetimit.

Për veprën penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur” parashikuar nga neni 101/22 i Kodit Penal, gjatë vitit 2023 është regjistruar 1 procedim penal, i cili është dërguar në gjyq me dy të pandehur. Ky procedim penal është i mbartur nga viti 2022 dhe kërkesa për gjyq është bërë me datë 11.09.2023, ndodhet para gjyqtarit të Seancës Paraprake.

Për veprën penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura” parashikuar nga neni 102/1 i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, i cili ndodhet në fazën e hetimeve.

Për veprën penale “Ngacmimi seksual” parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal është regjistruar 2 procedime penal të cilat ndodhen në fazën e hetimeve.

Për veprën penale të “Përndjekja” neni 121/a-1 i K.Penal, është mbartur një procedim penal nga viti i kaluar dhe janë regjistruar 3 procedime penale të reja, nga këto 4 procedime penale 2 janë dërguar në gjyq dhe 2 ndodhen në fazën e hetimeve.

Në lidhje me masat e sigurimit në lidhje me këto vepra penale është synuar në drejtim të ashpërsimit të politikës penale dhe kërkimit të masave të ashpra të dënimit. Në mbi 50 % e rasteve të referuara rezulton se janë aplikuar arrestet në flagrancë apo ndalimet sipas rastit. Gjithashtu, në kërkimet e prokurorisë në pjesën më të madhe është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg” në rastet e veprave penale të parashikuara nga nenet 130/a, 100, etj, të Kodit Penal duke vlerësuar edhe rrethanat e ngjarjeve, si dhe rrethanat lehtësuese apo rënduese. Edhe nga ana e gjykatës në pjesën më të madhe të rasteve është mbështetur kërkesa e prokurorëve. Vlen për tu theksuar se janë disa raste të procedimeve penale të filluara nga referimet e paraqitura nga gjykata në rastet e gjykimit të kërkesave për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes apo të miratimit të urdhrave të mbrojtjes.

Nga ana tjetër në rastet e hetimit të veprave penale në marrëdhëniet familjare “Përndjekje” “Dhunë në familje”, apo në lidhje me krimet seksuale dhe kundër moralit është kërkuar aplikimi i masave të ashpra të sigurimit, sigurimi i një mbrojtje dhe mbështetje për viktimat e këtyre veprave penale dhe zbatimi i një politike penale të ashpër për autorët e këtyre veprave penale.

Edhe në lidhje me masat e dënimit për këto vepra penale në fazën e gjykimit janë aplikuar masa relativisht të ashpra dënimesh. Në pjesën më të madhe të tyre janë kërkuar dënime me burgim dhe mbi mesataren që parashikon dispozita penale konkrete. Këto kërkesa kanë gjetur mbështetje edhe nga gjykata duke dhënë dënime me burgim për dhunuesit në një pjesë të madhe të çështjeve të gjykuara.

Vëmendje i është kushtuar respektimit të të drejtave të viktimës të veprës penale. Zakonisht viktima njoftohet për përfundimin e hetimeve, mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Ka angazhim nga prokurorët për t’iu përgjigjur kërkesave të viktimave gjatë fazës së hetimeve paraprake.



## **1.6 Bashkëpunimi ndërinstitucional, analiza të zhvilluara me këto institucione dhe zbatimi i akteve/ marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, me KLSH, me ILDKPI, BSH, etj.**

Në zbatim të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2023”, datë 06.07.2023, si dhe “Aktit të koordinimit ndërinstitucional” ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me nr.8126, miratuar me datë 05.12.2020, janë marrë masa në vijimësi për rritjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe rritjen e komunikimeve përsa i përket shkëmbimeve të informacioneve për procedimet reciproke me interes të përbashkët apo edhe të njëanshëm.

Duhet pranuar se në lidhje me zbatimin e Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional për shkak të kohës së shkurtër të implementimit të tij nuk ka pasur një rezultat të prekshëm. Nga ana tjetër gjatë këtij viti ka pasur një numër të caktuar rastesh të transferimeve të materialeve hetimore apo procedimeve me Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK).

Gjatë vitit 2023, kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme 3 materiale kallëzuese. Një material kallëzues regjistruar me numër kallzimi 449/2023 për veprën penale “Shpërdorim detyre”, i cili është bërë mosfillim, kallëzimi tjetër ka marrë numër kallëzimi 989/2023 për veprat penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “Fallsifikim i dokumentave” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal i cili është bërë mosfillim, dhe një kallëzim i cili ka marrë numër kallëzimi 1026 për veprën penale “Fallsifikim i dokumentave” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, i cili është bashkuar me procedimin penal nr.162 të vitit 2021 (procedim penal i mbartur, i regjistruar në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tropojë), dhe ndodhet në fazën e hetimit.

Nga ana jonë janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme, 3 kallëzime penale dhe 1 procedim penal, konkretisht është dërguar kallëzimi penal nr. 239/2023 për veprën penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, kallëzimi penal nr. 252/2023 për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal dhe për veprën penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, si dhe kallëzimin penal nr. 994/2023 për veprat penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal dhe “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës” parashikuar nga neni 321 Kodit Penal. Gjithashtu është dërguar në SPAK procedimi penal nr.994/2023 për veprën penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Edhe në vijim vlerësojmë se bashkëpunimi me Prokurorinë e Posaçme do të vijë në rritje, si në zbatim të “Aktit të koordinimit ndërinstitucional” ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me nr.8126, miratuar më datë 05.12.2020, por gjithashtu për shkak të procedimeve penale të lidhura si dhe faktit të hetimet të çështjeve për vepra penale në kompetencë të të dy prokurorive.

Përsa i përket institucioneve të tjera si MFE, MB, KLSH, ILDKPI, BSH bashkëpunimi ka qenë vetëm për marrje/dhënie informacione të shkresave të ndryshme me këto institucione, për qëllime hetimi.

### **1.7 Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe/ose nëpërmjet prokurorit ndërlidhës shqiptar në EUROJUST.**

Kemi patur një bashkëpunim shumë të mirë me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe përmirësimin e cilësisë së akteve dhe kryerjes së veprimeve procedurale, në kuadër të ekzekutimit të ekstradimeve dhe letërporosive. Falë këtij bashkëpunimi të gjitha procedurat e ekstradimit por edhe të ekzekutimit të letërporosive janë bërë duke respektuar afatet e përcaktuara në ligjin procedural penal dhe marrëveshjeve përkatëse të ndërsjellta.

Gjatë këtij viti kemi patur 10 kërkesa për ekstradim për Jashtë Shtetit, nga këto janë miratur 9 kërkesa për ekstradim.

Në lidhje me letërporosistë ardhur nga Jashtë Shtetit për vitin 2023, kanë ardhur 18 kërkesa (letërporosi) të cilat janë pranuar të 18 kërkesat, letërporosite për Jashtë Shtetit.

Gjithashtu për këtë vit janë dërguar për Jashtë 34 kërkesa për letërporosi, të bëra nga prokurorët dhe të 34 letërporositë për Jashtë Shteti janë miratur.

Në lidhje me njohjet e vendimeve penale të huaja dhe njohjet e vendimeve shqiptare jashtë shtetit nuk kemi patur raste për vitin 2023.

Përsa i përket tranferimeve të procedimeve penale kemi patur 6 tranferime të procedimeve penale nga Shqipëria për në Republikën e Kosovës, kjo për shkak se vepra penale ka ndodhur në Kosovë edhe pse shtetasit e përfshirë në ngjarje kanë qenë shtetas shqiptar. Më konkretisht procedimi penal nr.16/2023 tranferuar në Kosovë për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal. Procedimet penale 99/2023 dhe 101/2023 janë tranferuar në Republikën e Kosovës për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndodhur në pikën Kufitare Morinë nga pala kosovare, procedimi penal nr.184/2023 tranferuar në Republikën e Kosovës për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit” parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, procedimi penal nr. 265/2023 për veprën penale “Dhënie ndihmë për kalim të paligshëm kufiri shtetëror” parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, si dhe procedimi penal nr. 633/2023 për veprën penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

### **1.8 Specializimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre.**

Enkeleda Hoxha, me detyrë Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ka marrë pjesë në aktivitet trajnuese si më poshtë:

23 Janar - Hetimi proaktiv. Kuadri ligjor.

23-24 Shkurt - Veprat penale në fushën e tatimeve.

20-21 Mars 2023 - Afatet e paraburgimit.

24 Tetor 2023, Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal dhe praktika gjyqësore.

25 Tetor 2023, Aftësitë e prokurorit për prezantimin e çështjes në gjyq;

13 Nëntor 2023, Kontrolli i vendeve dhe banesës;

Artan Shtrungza, me detyrë Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

15 Dhjetor 2023, Krimi kibernetik. Kuadri Ligjor.

21 Dhjetor 2023, Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive.

Armida Kaçi, me detyrë Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

25 Tetor 2023, Aftësitë e prokurorit për prezantimin e çështjes në gjyq;

23 Nëntor 2023, Veprat penale me të dëmtuar akuzues Fyerja dhe Shpifja;

1 Dhjetor 2023, Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës;

15 Dhjetor 2023, Krimi kibernetik. Kuadri Ligjor;

20 Dhjetor 2023, Veprat penale të korrupsionit, teknikat e hetimit;

Redona Ndoni, me detyrë Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

23 Janar - Hetimi proaktiv. Kuadri ligjor.

25 Tetor 2023, Aftësitë e prokurorit për prezantimin e çështjes në gjyq;

1 Dhjetor 2023, Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës;

Seanca paraprake në tërësinë e saj; Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe kufijtë e saj, neni 427/4 i K.Pr.Penale. Bashkëpunëtori i jashtëm; Trafikimi i qënieve njerezore, (mock trial), 11-14 Dhjetor 2023, Ohër, Maqedoni.

Griselda Haxhiaj, me detyrë Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

13 Nëntor 2023, Kontrolli i vendeve dhe banesës;

1 Dhjetor 2023, Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës;

6 Dhjetor 2023, Aktet procedurale të mbajtura nga OPGJ-ja;

15 Dhjetor 2023, Krimi kibernetik. Kuadri Ligjor;

Vladimir Shehu, me detyrë oficer i policisë gjyqësore ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

15 Dhjetor 2023, Krimi kibernetik. Kuadri Ligjor;

21 Dhjetor 2023, Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive;

Bledar Xhoxha, me detyrë oficer i policisë gjyqësore ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

6 Dhjetor 2023, Aktet procedurale të mbajtura nga OPGJ-ja;

21 Dhjetor 2023, Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive;

Elton Hoxhaj, me detyrë oficer i policisë gjyqësore ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

3 Nëntor 2023 “Shpërblimi i dëmit që rrjedh nga Produktet dhe Shërbimet.”;

1 Dhjetor 2023, Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës;

15 Dhjetor 2023, Krimi kibernetik. Kuadri Ligjor;

21 Dhjetor 2023, Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive;

Krenar Lisha, me detyrë oficer i policisë gjyqësore ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

24 Tetor 2023, Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal dhe praktika gjyqësore;  
13 Nëntor 2023, Kontrolli i vendeve dhe banesës;  
1 Dhjetor 2023, Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës;  
6 Dhjetor 2023, Aktet procedurale të mbajtura nga OPGJ-ja;  
15 Dhjetor 2023, Krimi kibernetik. Kuadri Ligjor;

Remzi Duraku, me detyrë oficer i policisë gjyqësore ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

24 Tetor 2023, Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal dhe praktika gjyqësore;  
13 Nëntor 2023, Kontrolli i vendeve dhe banesës;  
1 Dhjetor 2023, Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës;  
6 Dhjetor 2023, Aktet procedurale të mbajtura nga OPGJ-ja;  
15 Dhjetor 2023, Krimi kibernetik. Kuadri Ligjor;

Nikoleta Marku, me detyrë oficer i policisë gjyqësore ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

24 Tetor 2023, Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal dhe praktika gjyqësore;  
21 Nëntor 2023 “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.”  
1 Dhjetor 2023, Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës;  
6 Dhjetor 2023, Aktet procedurale të mbajtura nga OPGJ-ja;  
20 Dhjetor 2023, Veprat penale të korrupsionit, teknikat e hetimit;

## **ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË.**

### **2.1 Volumi i punës në hetim (procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara si dhe vendimet e mosfillimit).**

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për vitin 2023 është ushtruar ndjekje penale dhe janë trajtuar **995 procedime penale**, duke përfshirë në këtë shifër procedimet penale të regjistruara gjatë vitit 2023 ku në total janë regjistruar **771** procedime penale, procedimet penale të mbartura nga viti 2022 që janë 195 procedime penale si dhe 29 procedime penale të rifillura nga pezullimet e viteve të mëparshme të cilat janë rifilluar për shkak të ardhjes së letërporosisë apo të zhvillimeve të reja në lidhje me autorët e ngjarjeve përkatëse.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë për vitin 2023, për periudhën 1 Janar 2023 – 30 Prill 2023 janë regjistruar **40 procedime penale**, nga të cilat 13 procedime penale janë përfunduar dhe 27 janë në fazën e hetimeve.

Numrin më të madh të këtyre procedimeve penale e zënë veprat penale për “Kalim të paligjshëm të kufirit”, ku për këtë vit janë regjistruar 215 procedime penale, veprat penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, ku për këtë vit janë regjistruar 118 procedime penale, vepra penale e “Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt” ku për këtë vit janë regjistruar 77 procedime penale, veprat penale të “Vjedhje” së pasurisë, ku për këtë vit janë regjistruar 60 procedime penale, për veprën penale të “Kultivim i bimëve narkotike” janë regjistruar 51 procedime penale, veprat penale të “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” 34 procedime penale, veprat penale të “Dhuna në familje” janë regjistruar 27 procedime penale, për veprat penale të “Shkatërrimi i pronës” me 26 procedime penale, veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” janë regjistruar 30 procedime penale, për veprën penale të “Prerja e paligjshme e pyjeve”, gjithsej 20 procedime penale, për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorike” gjithsej 20 procedime penale, për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” , gjithsej 17 procedime penale, veprat penale e “Plagosjes së lehtë me dashje”, ku për këtë vit janë regjistruar 17 procedime penale, për veprën penale të “Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik” janë regjistruar 8 procedime penale, etj.

### **2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë.**

Gjithsej për vitin 2023 kanë qenë në gjykim 514 çështje penale me 554 të pandehur, ndër ta, 101 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Nga këto janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë 14 procedime penale me 14 të pandehur, me gjykim të zakonshëm 12 procedime penale me 18 të pandehur, me gjykim të shkurtuar 170 procedime penale me 184 të pandehur dhe 1 gjykim në mungesë me 1 të pandehur.


Është kërkuar nga prokurori për 53 raste dënime me gjobë, është kërkuar burgim minimal për 20 raste, burgim mesatar për 33 raste, burgim duke aplikuar nenin (59) 111 raste, në total 169 procedime penale. Gjykata ka vendosur 53 dënime me gjobë, 20 raste burgim minimal, 33 raste burgim mesatar dhe aplikimi i nenit 59 për 111 raste.

Ka përfunduar gjykimi për 195 procedime penale me 217 të pandehur, dhe 39 persona me masë sigurimi arrest me burg.

### **2.3 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale, ku të trajtohet si tregues të dhënave për njoftimet/raportimet e qytetarëve për korrupsion.**

Për vitin 2023 në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë regjistruar gjithsej 1040 materiale kallëzuese nga të cilat janë referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, nga Seksioni i Autostradës Kukës – Morinë, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit dhe Komisariteve Policisë Kukës, Has, Tropojë 759 materiale kallëzuese, 214 materiale kallëzuese kanë ardhur me shpallje moskompetence nga prokuroritë e tjera, nga Prokuroria e Posaçme kanë ardhur 4 materiale kallëzuese, nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës janë referuar 33 materiale kallëzuese, nga shtetas janë regjistruar 16 materiale kallëzuese, dhe 14 materiale referuese nga institucione të tjera (1 Bashkia Kukës, 1 Drejtoria Hetimit Tatimor, 3 Agjencia e Mbikqyrjes Policore, 1 Agjencia e Zonave të Mbrojtura, 2 nga IKMT, 1 Reparti Ushtarak, 1 OSSH Tiranë, 1 nga banka Agro Credit, 1 nga PD Tiranë, 1 nga SH.K.Burgjeve Tiranë).

Me anë të grafikut të mëposhtëm po pasqyrojmë materialet referuese të ardhura gjatë vitit 2023.




**Figura 2.** Grafiku i materialeve referuese për vitin 2023

Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	1									
Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë										
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë										
Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike										
Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike										
Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë										
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë										

Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit										
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë										
Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare										
Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj										
Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja										
Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë										
Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare										
Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj										
Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja										
Neni 328 Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve										
<b>Totali</b>	<b>1</b>					-	-	-	-	-

KRIMI KIBERNETIK	2022					2023				
	Nr. Proc d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro genocitit ose krimeve kunder njerëzimit										
Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. kompj.										
Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik										

Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik										
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik										
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik										
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike										
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike										
Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve										
<b>Totali</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

TRAFIKIMI	2022					2023				
	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pa nd. Re gj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pan d den uar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pan d den uar
Neni 110/1 Heqja e paligjshme e lirisë	1	1	1	1						
Neni 128/b Trafikimi i të miturve										
Neni 138/a Trafikimi i veprave të										

artit dhe kulturës										
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	11	4	4	4		15	1	1	1	
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit	2					2	2	2	2	2
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive										
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve	7	2	2	2	1	6	3	3	3	3
<b>Totali</b>	<b>21</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>23</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>5</b>

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2022					2023				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	7	1	6	6	6	13	1	2	2	2
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	11	3	4	4	2	47	-	-	-	-
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale										

Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope										
Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i sustancave kimike										
<b>Totali</b>	<b>18</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>8</b>	<b>60</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>

---

## TREGUESIT NË HETIMET PARAPRAKE

---

### Treguesit e përgjithshëm të ndjekjes penale


Në vitin 2023 Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka mbartur prej vitit 2022, gjithsej 195 procedime penale me 26 persona nën hetim, 101 të pandehur, ndër të cilët 22 të arrestuar (arrest me burg). Gjithashtu janë riflluar 29 procedime penale të viteve të mëprshme, të cilat kanë qenë në statusin të pezulluara. Rifillme i tyre është bërë për shkak të zhvillimeve të reja si ardhja e letërporosisë nga jashtë shtetit, zhvillime të reja në lidhje me ngjarjen apo autorin e ngjarjes, apo ardhja e materialeve të reja shtesë që kanë lidhje me procedimet e pezulluara.

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 771 procedime penale me 158 persona nën hetim, 209 të pandehur, ndër të cilët 74 persona të arrestuar.

Duke bërë një krahasim me vitin e mëparshëm, rezulton se gjatë këtij viti janë regjistruar 143 procedime penale më shumë se viti i kaluar, ku një prej arsyeve kryesore të rritjes së numrit të procedimeve është dhe bashkimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, me datë 01.05.2023, aktualisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

Për vitin 2023 janë përfunduar gjithsej 675 procedime penale. Ndërsa kanë mbetur në hetim për vitin vazhdues 320 procedime penale me 111 persona nën hetim, ndër të cilët 42 persona të arrestuar, (kryesisht nenet: 78/1, 88/b, 129, 130 a/1, 130 a/4, 134, 172/1, 174/1, 190/1, 236/2, 237, 278/a-1, 283/1, 283/a-2, 284/1, 290/1/2/3, 323 etj).





**Figura 6:** Grafiku i procedimeve penale për vitin 2023

Mënyra e përfundimit të procedimeve penale gjatë vitit 2023 është si më poshtë vijon :

➤ **PROCEDIME PENALE TË PUSHUARA.**

Janë pushuar 231 procedime penale, 4 për mungesë prove dhe 227 për shkaqe të tjera, me 56 persona nën hetim.

1.1. Për mungesë provueshmërie janë pushuar 4 procedime penale nga të cilat: 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 i K.Penal.

1.2. Për shkaqe të tjera janë pushuar 227 procedime penale përkatësisht, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 91 i K.Penal, 6 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 99 të K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 109/1 i K.Penal, 5 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a-1 i K.Penal, 20 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 të K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, 5 procedime penale për veprën 141/a-1 të K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a-2 i K.Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 143/1 të K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 149 të K.Penal, 10 për veprat penale të parashikuara nga nenet 84 dhe 205 të K.Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuara nga neni 150 i K.Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i K. Penal, 2 procedime penale për veprën

penale të parashikuar nga neni 180/1 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 180/a-2 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 1801 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 182 i K.Penal, 4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 189/1 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 191/1 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i K. Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a-1 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i K. Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 204 i K. Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i K. Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 206 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 237 i K.Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i K.Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i K. Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i K.Penal, 9 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i K.Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 279/1 i K.Penal, 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a-2 i K.Penal, 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 284/1 i K.Penal, 10 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1 i K.Penal, 10 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, 79 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i K.Penal, si dhe nga një procedim penal për veprat e parashikuara nga nenet 298/1, 321/1 dhe 329/1 të K.Penal.

Numrin më të madh të këtyre procedimeve penale të pushuara e zënë veprat penale si shkatërrim i pronës, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt, kalimet e paligjshme të kufirit, shkatërrim i pronës me zjarr, plagosjes së lehtë, kanosja, prerjes së paligjshme etj.

#### ➤ **PROCEDIME PENALE TË PEZULLUARA.**

Është vendosur pezullimi i hetimeve për **91** procedime penale për shkak të mosidentifikimit të autorit të veprës penale.

Numrin më të madh të këtyre procedimeve penale vazhdojnë ta zënë vepra penale e vjedhjes (26 procedime penale), prerja e paligjshme në pyje (5 procedime penale), shkatërrimi i pronës (7 procedime penale), shkatërrimi i pronës me zjarr (6 procedime penale), kultivim i bimëve narkotike (15 procedime penale), trafikimi i mjeteve motorrike (8 procedime penale). Një numër i vogël procedimesh penale janë pezulluar për veprat penale të parashikuara nga nenet 297, 298/1, 283/b-1, 278/3, 274/a, 273, 199, 199/a-1, 189/1, 186/1, 161, 118, 109/1 të K.Penal.

Një vështirësi në hetimin e këtyre procedimeve penale ka qenë mbledhja e të dhënave dhe marrja e informacioneve qoftë edhe operative nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore për autorët

e mundshëm të këtyre veprave penale. Kjo ka ndodhur edhe tek ato ngjarje ku janë fiksuar dhe marrë gjurmë papilare të vlefshme për krahasim me persona të dyshuar për veprën penale të vjedhjes, por rezultatet nuk kanë qenë në dobi të hetimit.

#### ➤ **PROCEDIME PENALE KU ËSHTË SHPALLUR MOSKOMPETENCA.**

Është shpallur moskompetenca për **66** procedime penale, me 17 persona nën hetim, 1 të pandehur dhe 8 me masë sigurimi “Arrest me burg”.

Numrin më të madh të këtyre procedimeve penale e zënë veprat penale si “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 297 i K.Penal (44 procedime penale), “Trafikim i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/a (5 procedime penale) dhe një numër të vogël procedimesh penale për veprat penale parashikuar nga nenet: 298/1, 298/3, 290/1, 248, 205, 186/a-1, 183/1, 174/1, 143/2, 134/1, 130/a-1, 130/a-4, 79/b-1 të Kodit Penal.

#### ➤ **PROCEDIME PENALE DËRGUAR NË GJYQ.**

Eshtë kërkuar gjykimi çështjes për **287** procedime penale, me 299 të pandehur, ndër të cilët 46 me masën e sigurimit personal “Arrest në burg”.

Numrin më të madhe të procedimeve penale të dërguara për gjykim e zënë veprat penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, me 55 procedime penale me 55 të pandehur, nga të cilët 2 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Më pas renditen për veprën penale të “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 297 me 39 procedime penale, me 39 të pandehur.

Për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a-1 janë dërguar për gjyq 33 procedime penale me 33 të pandehur, “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a-3 janë dërguar për gjyq 19 procedime penale me 19 të pandehur.

Për veprën penale “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1, 130/a/2 të K.Penal, 12 çështje penale me 12 të pandehur, nga të cilët 6 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Për veprën penale të “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë” parashikuar nga neni 179/a janë dërguar në gjyq 12 procedime penale me 12 të pandehur.

Për veprën penale të “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298/1, 298/2 dhe 298/3 të K.Penal, 9 procedime penale, me 11 (njëmbëdhjetë) të pandehur dhe 9 “Arrest në burg”.

Për veprën penale të “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/1/2/3 të K.Penal, me 9 procedime penale me 9 të pandehur dhe 5 “Arrest në burg”.

Për veprën penale “Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i K.Penal, me 6 procedime penale me 6 të pandehur.


Për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i K.Penal, me 6 procedime penale, me 6 të pandehur, 3 me “Arrest në burg”.

Për veprën penale “Plagosje e lehtë” parashikuar nga neni 89 i K.Penal, 5 çështje penale me 5 të pandehur.

Për veprën penale të “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal, me 5 procedime penale, me 6 pandehur.

Për veprën penale të “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134/1/2, 5 çështje penale me 7 të pandehur, nga të cilët 2 të arrestuar.

Për veprat penale të parashikuara nga nenet 284/1, 323, 305, 273, 248, 237, 236/1/2, 205, 284/1/2, 283/1/2, 279/1, 278/a/1, 197, 190/1, 189/1, 180/a, 174/1, 151, 149/a, 141/a, 121/a/1, 110/b/1, 109/b/1 të K.Penal, me numër më të vogël procedimesh penale.



**Figura 7:** Çështjet e përfunduara për vitin 2023

**Më poshtë po i pasqyrojmë më hollësisht treguesit e ndjekjes penale sipas veprave penale:**

---

*VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT*

---

Në lidhje me veprat penale kundër personit (neni 76 – 92 i Kodit Penal), për vitin 2023 janë hetuar gjithsej 34 procedime penale, me 14 persona nën hetim, me 9 të pandehur, ndër të cilët 9 me masë sigurimi arrest në burg.

Gjatë këtij viti është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale “Vrasje me dashje” parashikuar nga neni 76-22 dhe 1 procedim penal është mbartur nga viti i kaluar. Nga këto 2 procedime penale 1 procedim penal është pushuar për mungesë prove dhe 1 procedim penal ndodhet në fazën e hetimeve.

Për veprën penale 78/1 është regjistruar 1 procedim penal me 2 persona nën hetim, dhe 2 persona arrest me burg, e cila ndodhet në fazën e hetimeve.

Për veprën penale “Vrasja me paramendim” parashikuar nga neni 78/b, është regjistruar 1 procedim penal gjatë këtij viti, me 6 persona nën hetim dhe 6 persona arrest me burg, e cila është transferuar.

Për veprën penale të “Kanosjes” parashikuar nga neni 84, janë regjistruar 7 procedime penale me 1 të pandehur dhe 1 procedim penal (i pezulluar vitet e mëparshme) është rifilluar. Nga këto procedime penale 3 janë pushuar, 1 është pezulluar, 1 është dërguar në gjyq me 1 të pandehur dhe 3 procedime penale ndodhen në fazën e hetimeve.

Për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal i cili ndodhet në fazën e hetimeve. Për veprën penale “Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” parashikuar nga neni 88/b është mbartur një procedim penal nga viti i kaluar, me 1 person nën hetim, 1 person arrest me burg, i cili ndodhet akoma në fazën e hetimit.

Për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal janë mbartur 3 procedime penale me 2 të pandehur nga viti i kaluar dhe janë regjistruar 14 procedime penale me 2 persona nën hetim dhe 5 të pandehur, nga të cilat 12 procedime penale janë pushuar me 2 persona nën hetim, dhe 5 procedime penale janë dërguar në gjyq me 5 të pandehur.

Për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje” parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal i cili është pushuar.

Për veprën penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia” parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal janë mbartur 2 procedime penale nga viti i kaluar me 1 të pandehur, nga të cilat 1 procedim penal është pushuar dhe 1 procedim penal është dërguar në gjyq me 1 të pandehur.

Në këndvështrim krahasues me vitin 2022 konstatohet dhe gjatë këtij viti për këtë grup veprash penale ka pak a shumë të njëjtat shifra të regjistruara me vitin e kaluar.

---

#### VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

---

Janë mbartur nga viti i kaluar 73 procedime penale me 4 persona në hetim, me 36 persona të pandehur dhe 4 persona arrest me burg.

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 235 procedime penale

Kanë ardhur me shpallje moskompetence nga Prokuroritë e tjera 11 procedime penale.

Për vitin 2023 janë pushuar gjithsej 65 procedime penale për veprat kundër pasurisë dhe ekonomisë (nenet 134-200), nga të cilat 3 janë pushuar për mungesë fakti dhe 62 procedime penale për shkaqe të tjera me 8 persona në hetim (1 person i është pushuar çështja për mungesë prove dhe 7 personave i është pushuar çështja për shkaqe të tjera).

Numrin më të madh të pushimeve e zënë procedimet penale për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 me 20 procedime penale, vepra penale “Shkatërrimi i pronës” parashikuar nga neni 150 me 13 procedime penale, për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike” parashikuar nga neni 141/a-1 me 5 procedime penale, “Fallsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 me 4 procedime penale, e “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a/1 me 3 procedime penale, për veprën penale “Shkatërrim i pronës me zjarr” parashikuar nga neni 151 janë pushuar 3 procedime penale, për veprën penale “Mashttrim” parashikuar nga neni 143/1 janë pushuar 3 procedime penale, si dhe nga 2 procedime penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 180/1, 161 të K.Penal.

Janë pushuar hetimet me nga 1 procedim për veprat penale të parashikuara nga nenet 137, 141/a-2, 149, 180/a-2, 181, 182, 189/1, 191/1, 197, 200 të K.Penal.

Janë *pezulluar* për mosnjohje të autorit të veprës penale 55 procedime penale.

Numrin më të madh vazhdon ta ketë vepra penale “Vjedhja” parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal 26 procedime penale, për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike” parashikuar nga neni 141/a-1 i Kodit Penal 8 procedime penale, “Shkatërrimi i pronës” parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal janë pezulluar 7 procedime penale, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr” parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal 6 procedime penale dhe me nga 2 procedime penale për veprat penale parashikuar nga nenet 161, 199/a-2 të Kodit Penal, me nga 1 procedim penal për veprat penale parashikuar nga nenet 156/1, 186/1, 189/1, 199 të Kodit Penal.

Është vendosur shpallja e moskompetencës për 11 procedime penale.

Nga këto vepra penale, *janë dërguar për gjykim* 101 procedime penale me 106 të pandehur, ndër ta, 4 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Vendin kryesor të procedimeve penale të dërguar për gjykim për këto grup veprash penale e zënë për veprën penale të “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a1/a2/a3 me 53 procedime penale me 53 të pandehur, për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a 12 procedime penale me 12 të pandehur, për veprat penale parashikuar nga nenet 150, 186/1, 143/1 nga 5 procedime penale për secilin nen, për veprën penale të vjedhjes së pasurisë me 4 procedime penale dhe më pak raste zënë veprat e tjera të Kodit Penal.

Gjatë këtij viti, për këto grup veprash penale janë përfunduar hetimet për 232 procedime penale, me 8 persona nën hetim, me 106 të pandehur, ndër të cilët 4 të arrestuar. Kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 104 procedime penale me 40 të pandehur.

Problematikë është mos zbulimi i autoreve për veprat penale të “Vjedhjes”, ku janë pezulluar 26 procedime penale për shkak të mosgjethjes së autorit të kësaj vepre penale. Problematikë në hetimin e kësaj vepre penale ka qenë mungesa e mbledhjes së të dhënave dhe marrja e informacioneve në rrugë të ndryshme nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore për autorët e

mundshëm të veprës penale. Kjo ka ndodhur edhe tek ato ngjarje ku janë fiksuar dhe marrë gjurmë daktiloskopike të vlefshme për t'u krahasuar me persona të dyshuar.

---

### VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

---

Nga viti 2022 janë mbartur 6 procedime penale me 1 të pandehur dhe gjatë këtij vitit janë regjistruar 19 procedime penale me 3 persona nën hetim dhe 2 të pandehur, dhe janë rifilluar 4 procedime penale të pezulluara vitet e mëparshme. Nga këto procedime penale janë pushuar 5 procedime penale me 1 person nën hetim, janë pezulluar 6 procedime penale për mos gjetje të autorit të veprës penale, 2 procedime penale janë transferuar dhe 3 çështje me 3 të pandehur janë dërguar në gjyq. Numrin më të madh të çështjeve të regjistruara për këtë grup veprash penale e zë vepra penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal për të cilin gjatë këtij viti janë regjistruar 12 procedime penale me 3 persona nën hetim dhe 2 të pandehur.

---

### VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHKETIT

---

Në lidhje me veprat penale kundër autoritetit të shtetit, ku janë grupuar veprat penale të parashikuara nga nenet 235 – 299 të Kodit Penal, nga viti i kaluar janë mbartur 87 procedime penale, me 17 persona nën hetim, 52 të pandehur dhe 15 arrest me burg. Gjatë këtij viti janë regjistruar në total 442 procedime penale me 86 persona nën hetim, 119 të pandehur dhe 42 persona me masë sigurimi arrest me burg, nga të cilat ardhur me transferim 187 procedime penale, me 26 persona në hetim dhe 25 persona të pandehur.

Gjithsej ka patur në hetim për këto grup veprash penale 530 **procedime penale** me 103 persona nën hetim e 171 të pandehur, nga të cilët 57 persona të arrestuar.

Janë pushuar gjithsej 129 procedime penale, me 40 persona nën hetim.

Janë **pezulluar** hetimet për mosnjohje të autorit për 25 procedime penale, nga të cilat 15 procedime penale për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 të K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 297 të K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm kufiri shtetëror” parashikuar nga neni 298/1, 2 procedime penale për nenin 278/3 të Kodit Penal dhe nga 1 procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 242, 273, 274/a, 293/b/1 të K.Penal.

Është vendosur **shpallja e moskompetencës** për 49 procedime penale me 6 persona në hetim, 1 të pandehur dhe 1 me masë sigurimi arrest me burg. Nga këto procedime penale numrin më të lartë e mban vepra penale “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” me 44 procedime penale, me 3 persona nën hetim.

Janë **dërguar gjyqit** 157 procedime penale me 164 të pandehur, nga të cilët 34 prej tyre kanë qenë me masën e sigurimit “Arrest në burg”.

Në këtë kategori pjesën më të madhe të procedimeve penale të **dërguara në gjyq** e zënë veprat penale:

- 55 procedime penale për veprën penale “Drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291, me 55 të pandehur, nga të cilët 2 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

- 39 procedime penale për veprën penale “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal, me 39 të pandehur.

- 9 procedime penale për veprën penale “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 298/1/2/3 të Kodit Penal, me 11 të pandehur, nga të cilët 9 me masë sigurimi arrest me burg.

- 9 procedime penale për veprën penale “Shkelja rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290, me 9 të pandehur, nga të cilët 5 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

- 6 procedime penale për veprën penale “Prodhim dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a, me 6 të pandehur, nga të cilët 3 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Veprat penale të tjera në këtë kategori zënë një vend më të vogël procedimesh penale të dërguara në gjyq kryesisht me nga 1, 2, 3 procedime penale.

Gjatë vitit 2023 janë përfunduar gjithsej për këto grup veprash penale 360 procedime penale, me 46 persona në hetim, me 165 të pandehur, nga të cilët 35 me masë sigurimi “Arrest në burg”. Kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 170 procedime penale me 57 persona në hetim, 6 të pandehur dhe 22 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Ndërsa konstatohet një rritje e konsiderueshme e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, pothuajse kemi një 4-fishim nga viti i kaluar. Rezultoni që pjesa më e madhe e këtyre kallëzimeve penale ka ardhur nga Komisariati i Policisë Tropojë dhe kultivimi bëhet pikërisht në zonën e Tropojës, i cili nga konstatimet është terren shumë i vështirë për zbulimin e autorit të veprës penale.

---

### VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

---

Për këtë grup veprash penale (nenet 300 – 324 të Kodit Penal) nga viti 2022 janë mbartur 8 procedime penale, 8 të pandehur dhe 7 persona me masë sigurimi arrest me burg, dhe janë regjistruar gjatë këtij viti 11 procedime penale, 11 të pandehur, 8 persona me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ka përfunduar gjykimi për 4 procedime penale, me 4 të pandehur dhe me 4 persona arrest me burg. Mbeten në gjykim për vitin 2024, 7 procedime penale, 7 të pandehur, 4 me masë sigurimi arrest me burg.



---

## VEPRAT PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA

---

Përsa i përket veprave penale që prekin zgjedhjet e lira, rezulton se për vitin 2023, është regjistruar vetëm një procedim penal për veprën penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” parashikuar nga neni 329/1 i Kodit Penal, i cili është pushuar.

Në fazën e gjyqimit nuk kemi asnjë procedim penal të mbartur apo të regjistruar gjatë këtij viti në lidhje me këtë grup veprash penale.

---

## TREGUESIT NË GJYKIM

---


### **Treguesit e përgjithshëm të çështjeve penale të gjykuara**

Gjithsej për vitin 2023 kanë qenë në gjykim gjithsej 514 çështje penale me 554 të pandehur, ndër ta, 101 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Nga këto janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë 14 procedime penale me 14 të pandehur, me gjykim të zakonshëm 12 procedime penale me 18 të pandehur, me gjykim të shkurtuar 170 procedime penale me 184 të pandehur dhe 1 gjykim në mungesë me 1 të pandehur.

Është kërkuar nga prokurori për 53 raste dënim me gjobë, është kërkuar burgim minimal për 20 raste, burgim mesatar për 33 raste, burgim duke aplikuar nenin (59) 111 raste, në total 169 procedime penale. Gjykata ka vendosur 53 dënime me gjobë, 20 raste burgim minimal, 33 raste burgim mesatar dhe aplikimi i nenit 59 për 111 raste.

Ka përfunduar gjykimi për 195 procedime penale me 217 të pandehur, dhe 39 persona me masë sigurimi arrest me burg.



**Figura 8:** Gjykuar me gjykim të drejtpërdrejt, urdhër penal, me marrëveshje

Kanë mbetur në gjykim për vitin 2024 në total 319 procedime penale me 337 të pandehur dhe 62 pesona me masë sigurimi arrest me burg.

**Masat e marra dhe rezultatet e treguesit në zbatimin e urdhërit penal, marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe gjykimin të drejtpërdrejtë dhe dënimet alternative.**

Puna dhe detyrat e prokurorëve dhe e oficerëve të policisë gjyqësore edhe gjatë vitit 2023 është orientuar dhe nxitur që të kryhet në përputhje të plotë dhe në respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo duke pasur parasysh të parimet themelore të legjislacionit penal dhe procedurialo-penal. Është synuar drejt kryerjes së hetimeve të shpejta dhe sa më të plota, duke pasur parasysh edhe vështirësitë e krijuara nga mungesat në strukturën e prokurorisë dhe policisë, vonesat në marrjen e përgjigjeve nga institucione të ndryshme dhe mungesat e ekspertëve të fushave të ndryshme.

Vlerësojmë të permendim se:

- a. Gjatë këtij viti janë dërguar në gjykatë 17 (shtatëmbëdhjetë) procedime penale me urdhër penal, ku nga Gjykata janë miratuar 17 urdhëra penal. Këto kërkesa janë për veprat penale “Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”, “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” dhe “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë” të parashikuara nga nenet 242, 297, 179/a të Kodit Penal. Megjithëse u është kërkuar dhe janë nxitur prokurorët në aplikimin e këtij instituti kjo mangësi vlerësoj se nuk ka ardhur kryesisht për neglizhencë por për shkak të qëndrimit apo sjelljes së të pandehurve apo edhe mosplotësimin të kushteve të tjera ligjore.

- b. Gjatë vitit 2023, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, janë përfunduar hetimet dhe janë dërguar në gjykatë 5 (pesë) procedime penale me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë së të pandehurit dhe caktimin e dënimit, kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 297. Këto marrëveshje janë miratuar nga Gjykata.
- c. Gjithashtu, 14 (katërmbëdhjetë) procedime penale janë dërguar në gjykatë me procedurën e gjykimit të drejtëpërdrejtë, për të cilat gjykata ka vendosur pranimin e tyre për të proceduar me gjykim të drejtëpërdrejtë. Kryesisht ky institut është aplikuar në rastet e veprës penale të parashikuar nga neni 291 dhe një rast për nenin 323 të Kodit Penal.

Nga procedimet penale të dërguara për gjykim, është kërkuar nga prokurori aplikimi i dënimeve alternative nenin 59 (vënia në provë) për 111 procedime penale, kjo duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrezikshmërinë e pakët të veprës penale dhe rrezikshmërinë e pakët të autorit, personalitetin e tij dhe rrethanat lehtësuese. Aplikimi i dënimeve alternative është kërkuar në rastet e veprave penale me rrezikshmëri të vogël si ato të parashikuara nga nenet 297, 291, 290/2, 199/a, 205, 237, 89, 242, 200, 143/1, 89, 130/a/1, 298/1/2, etj. të Kodit Penal.

#### **IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIT TË PUNËS SË PROKURORISË.**

##### **❖ Llojet dhe dhe masa e dënimit të kërkuara nga prokurorët:**

Për 53 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobë, për 20 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 33 të pandehur dënimi me burgim mesatar si dhe është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë për 111 të pandehur.

##### **❖ Vendimet e Gjykatës për llojet dhe masat e dënimit:**

Për 53 të pandehur është vendosur dënimi me gjobë, për 20 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 33 të pandehur me burgim mesatar, dhe është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë për 111 të pandehur, për 1 çështje është vendosur pushimi i çështjes, për 2 të pandehur është vendosur pafajësi nga ana e Gjykatës pasi nuk provohet se i pandehuri te kete kryer veprën penale për të cilën akuzohen si dhe në 1 çështje është vendosur kthimi i akteve organit të Prokurorisë.

##### **❖ Të dhënat për vendimet e pafajësisë, ndryshimet e cilësimit juridik të veprës penale në gjykatë apo gjatë hetimeve paraprake si dhe kërkesat për pushim me persona të arrestuar:**

Për vitin 2023 nga gjykata është dhënë pafajsi në 2 raste, për veprën penale të parashikuar nga neni 297 dhe 182/a-1 të K.Penal.

Për këtë vit është vendosur pafajsi nga gjykata për tre raste. Në dy raste është vendosur pafajsi, konkretisht për nenet 179/a dhe 182/a ku prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes në konkluzione. Ndërsa për një rast pafajsi të dhënë nga gjykata për nenin 134, është ushtruar e drejta e ankimit në nga prokurori Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila vazhdon të jetë në shqyrtim akoma.

Me ndryshimet Ligjore në K.Pr.Penale roli i gjykatës në kontrollin e hetimit ka evidentuar efikasitet në ngritjen e akuzave nga prokurori dhe administrim të drejtë, të saktë e ligjor të provave në hetim për të vërtetuar akuzat.

##### **❖ Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si gjinia, mosha, arsimi, punesimi etj.**


Për vitin 2023 janë dënuar 207 të pandehur (të moshës mbi 18 vjeç), nga këto 196 janë meshkuj dhe 11 të pandehura femra dhe 8 shtetas të mitur meshkuj meshkuj (të moshës 14-18 vjeç).

Janë dënuar 183 persona me arsim 8-9 vjeçarë, 47 persona me arsim të mesëm dhe 2 persona me arsim të lartë.

Janë dënuar: 1 person me gjendje shoqërore nëpunës i mesëm, 1 person me gjendje shoqërore nëpunës i ulët, 28 persona në sektor privat si dhe 184 persona të papunë.

Janë dënuar 94 persona me banim në qytet dhe 121 persona me banim në njësitë administrative të Bashkive Kukës, Tropojë e Has.

Janë dënuar 210 persona me gjendje gjyqësore të padënuar, 5 persona me gjendje gjyqësore përsëritës të veprave penale të ndryshme.



**Figura 9:** Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit

❖ **Të dhënat për procedimet penale për të miturit në konflikt me ligjin:**

Gjatë këtij viti janë regjistruar 49 (dyzet e nëntë) referime penale me të mitur. Nga këto 19 referime janë bërë mosfillime, ku në 6 prej tyre është zbatuar shmangia nga përgjegjësia penale ndërsa 13 referime janë mosfilluar për shkaqe të tjera, si mosha etj.

Përsa i përket procedimeve penale me të mitur janë regjistruar 30 procedime penale, nga të cilat 15 procedime penale janë pushuar (14 prej tyre është aplikuar shmangie paralajmërim me shkrim dhe 1 rast është pushuar për shkaqe të tjera), janë transferuar 4 procedime penale dhe 2 procedime penale janë dërguar në gjyq. Ndodhen në fazën e hetimit 9 procedime penale me të mitur. Në të gjitha rastet është synuar shmangia e masës së sigurimit “Arrest në burg” për personat e mitur në konflikt me ligjin pasi, vetëm një person rezulton përsëritës, dhe është vendosur masë sigurimi “Vendosja në mbikqyrje e të miturit ” sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

## **Më poshtë po i trajtojmë më hollësisht treguesit e çështjeve penale në gjykim.**

---

### *VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT*

---

Nga viti 2021 janë mbartur në gjykim 16 çështje penale me 21 të pandehur, nga të cilët 5 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Gjatë vitit 2023 janë dërguar për gjykim 23 çështje penale me 28 të pandehur, nga të cilët 5 persona të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej nga ky grup veprash penale 7 procedime penale me 9 të pandehur.

Për vitin 2024 kanë mbetur në gjykim 16 çështje penale me 19 të pandehur, ndër të cilët 5 të arrestuar.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga Prokurorët :

Dënim me burgim në minimum (neni 89 i K.Penal), për 3 të pandehur, për 3 të pandehur dënimi me burgim me kusht për 6 të pandehur.

Edhe nga ana e Gjykatës janë dhënë dënime sipas kërkesës së bërë nga ana e Prokurori.

---

### *VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË*

---

Janë mbartur në gjykim nga viti 2022 gjithsej 59 çështje penale me 60 të pandehur nga të cilët 4 të arrestuar.

Për vitin 2023 janë dërguar gjithsej në gjykim 160 çështje penale me 166 të pandehur nga të cilët 8 të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej 61 çështje penale, me 65 të pandehur, nga të cilët 5 të arrestuar.

Për vitin 2024 kanë mbetur në gjykim 99 çështje penale me 101 të pandehur me 3 të arrestuar.

*Në konkluzionet përfundimtare nga Prokurorët janë kërkuar këto lloje dhe masa dënimi:*

Për 5 të pandehur dënim me burgim në minimum, dënim mesatar për 4 çështje dhe me gjobë 7 çështje. Për 47 të pandehur pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Për këtë grup veprash penale Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka vendosur në përputhje me kërkesën e Prokurorit.

---

### *VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT*

---

Nga viti 2022 janë mbartur 6 procedime penale me 6 të pandehur dhe janë regjistruar gjatë vitit 2023 9 procedime penale me 9 të pandehur.

Për vitin 2023 janë dërguar për gjykim 2 çështje penale me 2 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 205 të K.Penal, dhe mbeten në hetim për vitin 2024 në total 7 procedime penale me 7 të pandehur.

Është kërkuar nga ana e Prokurorit dënim me gjobë për 1 çështje me 1 të pandehur, kërkesë e cila është miratuar nga ana e Gjykatës dhe 1 aplikim i nenit 59 e cila gjithashtu është miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

---

#### *VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHPETIT*

---

Nga viti 2022 kanë janë mbartur 120 çështje penale me 142 të pandehur, nga të cilët 29 të arrestuar. Gjatë vitit 2023 janë dërguar për gjykim për këto grup veprash penale 277 çështje penale me 306 të pandehur, me 63 të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej 110 çështje penale me 126 të pandehur, nga të cilët 24 të arrestuar.

Për vitin 2024 kanë mbetur në gjykim për këto grup veprash penale 167 çështje penale me 180 të pandehur, nga të cilët 39 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga prokurorët këto lloje dhe masa dënimi :

Për 45 të pandehur dënim me gjobë, për 3 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 26 të pandehur dënim me burgim mesatar dhe për 54 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Gjykata ka vendosur për 45 të pandehur dënim me gjobë, për 3 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 26 të pandehur dënim me burgim mesatar dhe për 54 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Për 1 të pandehur është vendosur pafajsi nga gjykata dhe për 1 çështje kthimi i akteve.

---

#### *TREGUESIT E MASAVE TË SIGURIMIT*

---

Gjatë vitit 2023 janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore 131 të pandehur dhe 1 urdhër ndalimi.

Janë ndaluar me urdhër të Prokurorit 7 të pandehur.

Është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “*Arrest në burg*” në mungesë për 7 të pandehur.

Rezulton se gjykata ka vleftësuar si të ligjshme arrestet në flagrancë si dhe urdhërat e ndalimit të bëra nga ana e Prokurorisë.

Është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg” për 52 të pandehur, për 7 të pandehur masa e sigurimit “Arrest në burg” në mungesë, për 6 persona nën hetim masa e sigurimit “Arrest në burg” me afat, për 15 të pandehur masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, për 52 të pandehur “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” si dhe në 4 rastë masa e sigurimit “Garanci Pasurore”.

Gjykata ka vendosur për 49 të pandehur masën e sigurimit “Arrest në burg”, për 7 të pandehur “Arrest në burg” në mungesë, për 15 të pandehur “Arrest në shtëpi”, për 10 të pandehur “Arrest në burg” me afat, për 52 të pandehur “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” si dhe për 4 të pandehur masën e sigurimit “Garanci Pasurore”.

Gjithashtu gjykata ka vendosur një masë ndaluese, për një urdhër ndalimi të kërkuar nga prokuroria.

Nga treguesit statistikor konstatojmë se janë mbështetur nga gjykata në pjesën më të madhe kërkesat e prokurorit për caktimin e masës shtrënguese.

Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar në ato raste për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, shtrirjen e veprës penale në vend.

Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar për veprat penale kundër jetës së personit, plagosjes së rëndë me dashje, tek vepra penale e dhunës në familje, tek veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë, për krimet në fushën e doganave, si vepra penale e kontrabandës, si dhe tek veprat penale kundër autoritetit të shtetit, falsifikimi i dokumentave, prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike, parashikuar nga nenet 283 e 284 të K.Penal, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, parashikuar nga nenet 290/1/2/3 të K.Penal tek veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, tek veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, kur drejtuesi i mjetit ka qenë recidivist në rastet kur ka qenë i pa pajisur me leje drejtimi apo kur drejtuesi i mjetit ka qenë në gjendje të dehur etj.

---

#### *TREGUESIT E KËRKESAVE PËR PUSHIM TË ÇESHTJES*

---

Kërkesat e Prokurorit për pushim të çështjes janë pranuar nga gjykata në pothuaj 100% të rasteve, me përjashtim të një çështje kur është vendosur kthimi i akteve Prokurorit. Ky tregues konfirmon saktësinë e vlerësimit të provave nga ana e prokurorit në hetim. Numri më i madh i këtyre kërkesave është për çështje që pushohen në aplikim të nenit 66 të Kodit Penal.

Nisur nga numri i seancave gjyqësore ku proceduralisht prokurori ka të detyrueshme pjesmarrjen, vlerësohet se një inisiativë për rishikimin e nenit 329/b, paragrafi 2, i K.Pr.Penale lidhur me praninë e prokurorit në seancën gjyqësore për pushimin e çështjes në rastet e aplikimit të nenit 66 të Kodit Penal, do të rriste efikasitetin e prokurorit në hetim. Kërkesat për pushim të çështjes penale në aplikim të nenit 66 të Kodit Penal, kërkojnë kohë fizike të detyrueshme për pjesmarrje në seancat gjyqësore të konsiderueshme dhe objektivisht pa asnjë lloj produkti ligjor. Kjo kohë do të ishte shumë me produktive në funksion të hetimit penal.



Gjithsesi ky konstatim e sugjerim duhet vlerësuar duke konsideruar saktë raportin specifikisht të këtyre lloj kërkesash proceduriale në çdo Zyrë Prokurorie.

Pjesmarrja e Prokurorëve në seancat gjyqësore ka rezultuar korrekte, pavarësisht ngarkesës që ka ekzistuar.

---

#### *TREGUESIT E ZGJATJES SË AFATEVE TË HETIMEVE PARAPRAKE*

---

Afatet e hetimit janë zgjatur si më poshtë vijojnë:

- ❖ Deri në 3 muaj për 8 procedime penale me 8 të pandehur, asnjë prej tyre nuk ka qenë i arrestuar.
- ❖ Mbi 3 muaj deri në 6 muaj janë zgjatur afatet për 7 procedime penale me 7 të pandehur dhe 2 të arrestuar.
- ❖ Mbi 6-9 muaj janë zgjatur hetimet për 1 procedim penale me 2 të pandehur dhe me 2 të arrestuar.
- ❖ Mbi 9 muaj nuk kemi patur asnjë zgjatje hetimi.
- ❖ Po kështu edhe mbi 1 vit nuk kemi patur asnjë zgjatje hetimi lidhur me procedimet penale të regjistruara nga ana e Prokurorisë Kukës.

Siç shihet nga treguesit statistikor ka patur angazhim për të përfunduar hetimet paraprake në një kohë sa më shpejtë të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi zgjidhjes së duhur të procedimeve penale brenda afatit ligjor, duke garantuar dhe respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke garantuar të drejtat proceduriale të subjekteve të procedimit penal si dhe dhënien e drejtësisë në kohë.

---

#### *TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME JASHTË*

---

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur në gjykatë 10 (dhjetë) **kërkesa për ekstradim për Jashtë Shtetit** të personave të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të kërkuar nga Autoritetet e Shteteve të Tjera.

Gjykata ka vendosur lejimin e ekstradimit për 9 persona dhe për 1 ekstradim jemi në pritje të vendimit të formës së prerë nga gjykatat, pasi janë ankuar subjektet.

Janë ekzekutuar **18 letërporosi nga jashtë shtetit**, kryesisht nga autoritetet e drejtësisë kosovare, që kanë patur të bëjnë me njoftimin e dëshmitarëve apo të të pandehurit, pyetjen e dëshmitarëve, etj.

Janë dërguar **34 letërporosi për jashtë shtetit**.

Për vitin 2023 nuk kemi patur asnjë rast për njohje të vendimit penal të huaj.

Për vitin 2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë bërë 2 urdhëra për kërkim ndërkombëtar nga prokurorët, gjithashtu

janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 1 shtetas i dënuar në mungesë dhe për 2 shtetas me masa sigurimi.

---

*TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE*

---

Nga viti 2022 kanë qenë të mbartura vendime të pa ekzekutuara për 23 të dënuar me burgim, për 263 të dënuar me gjobë dhe 132 të dënuar me kusht.

Gjatë vitit 2023 janë nxjerrë nga Prokuroria urdhërat e ekzekutimit të vendimeve penale për 41 të dënuar me burgim, për 46 të dënuar me gjobë, për 187 të dënuar me kusht dhe për 21 të dënuar duke aplikuar nenin 63 të K.Penal. (12 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 291 të K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 297 të K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 172/1 të K.Penal, si dhe nga 1 procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 237, 130/a/1, 199, 199/a/1 e 242 të K. Penal).

## **V. TREGUESIT LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA.**

Gjatë vitit 2023 kemi patur një bashkëpunim shumë të mirë me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe përmirësimin e cilësisë së akteve dhe kryerjes së veprimeve procedurale, në kuadër të ekzekutimit të ekstradimeve dhe letërporosive. Falë këtij bashkëpunimi të gjitha procedurat e ekstradimit por edhe të ekzekutimit të letërporosive janë bërë duke respektuar afatet e përcaktuara në ligjin procedural penal dhe marrëveshjeve përkatëse të ndërsjellta.

Gjatë këtij viti kemi patur 10 kërkesa për ekstradim për Jashtë Shtetit, nga këto janë miratur 9 kërkesa për ekstradim.

Në lidhje me letërporositë ardhur nga Jashtë Shtetit për vitin 2023, kanë ardhur 18 kërkesa (letërporosi) të cilat janë pranuar të 18 kërkesat, letërporositë për Jashtë Shtetit.

Gjithashtu për këtë vit janë dërguar për Jashtë 34 kërkesa për ndihmë jurike, të bëra nga prokurorët dhe të 34 letërporositë për Jashtë Shteti i është dhënë rrugë nga Ministria e Drejtësisë.

Në lidhje me njohjet e vendimeve penale të huaja dhe njohjet e vendimeve shqiptare jashtë shtetit nuk kemi patur raste për vitin 2023.

Përsa i përket tranferimeve të procedimeve penale kemi patur 6 tranferime të procedimeve penale nga Shqipëria për në Republikën e Kosovës, kjo për shkak se vepra penale ka ndodhur në Kosovë edhe pse shtetasit e përfshirë në ngjarje kanë qenë shtetas shqiptar dhe kallëzimin e kanë bërë në Shqipëri apo ngjarja ka ndodhur jashtë vendit tonë. Më konkretisht procedimi penal nr.16/2023 tranferuar në Kosovë për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal. Procedimet penale 99/2023 dhe 101/2023 janë transferuar në Republikën e Kosovës për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndodhur në pikën Kufitare Morinë nga pala kosovare, procedimi penal nr.184/2023 tranferuar në Republikën e Kosovës për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit” parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, procedimi penal nr. 265/2023 për veprën penale “Dhënie ndihmë për kalim të paligshëm kufiri shtetëror” parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, si dhe procedimi penal nr. 633/2023 për veprën penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

Për vitin 2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë bërë 2 urdhëra për kërkim ndërkombëtar nga prokurorët, gjithashtu janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 1 shtetas i dënuar në mungesë dhe për 2 shtetas me masa sigurimi.

## **VI. TË DHËNA PËR NGARKESËN DHE TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT, SHEFAT E SEKTORIT, ZËVENDËS PROKURORI DHE DREJTUESI I PROKURORISË.**

Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ka patur ndryshime në strukturën organike si rezultat i bashkimit të Prokurorisë Tropojë me Prokurorinë Kukës, por dhe si rezultat i lëvizjes së prokurorëve për arsye të ndryshme.

Nga data 01.01.2023 deri më datë 01.05.2023 kanë ushtruar detyrën 4 prokurorë: Xhevahir Lita (Drejtuesi i Prokurorisë), Enkeleda Hoxha (zv.Drejtuesi i Prokurorisë), Redona Ndoni (prokuror), ndërsa Griselda Haxhijaj (prokuror) këtë periudhë ka qenë me leje lindje. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kanë ushtruar funksionin 5 oficerë të policisë gjyqësore: Vladimir Shehu, Remzi Duraku, Krenar Lisha, Bledar Xhoxha dhe Nikoleta Marku. Bledar Xhoxha është emëruar oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës me vendimin nr.08, datë 13.01.2023 nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Nikoleta Marku emëruar oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës me vendimin nr.09, datë 13.01.2023 nga Prokuroria e Përgjithshme.

Nga data 01.05.2023 deri më datë 31.07.2023 kanë ushtruar detyrën 6 prokurorë: Xhevahir Lita (Drejtuesi i Prokurorisë), Enkeleda Hoxha (zv.Drejtuesi i Prokurorisë), Artan Shtrungza (prokuror), Armida Kaçi (prokuror), Redona Ndoni (prokuror), ndërsa Griselda Haxhijaj (prokuror) këtë periudhë ka qenë me leje lindje. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kanë ushtruar funksionin 6 oficerë të policisë gjyqësore: Vladimir Shehu, Elton Hoxhaj, Remzi Duraku, Krenar Lisha, Bledar Xhoxha dhe Nikoleta Marku.

Nga data 31.07.2023 deri më datë 31.12.2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës kanë ushtruar detyrën 5 prokurorë: Enkeleda Hoxha (Drejtues i Prokurorisë), Artan Shtrungza (prokuror), Armida Kaçi (prokuror), Redona Ndoni (prokuror), ndërsa Griselda Haxhijaj (prokuror). Kanë ushtruar detyrën e oficerit të policisë gjyqësore 6 oficerë të policisë gjyqësore: Vladimir Shehu, Elton Hoxhaj, Remzi Duraku, Krenar Lisha, Bledar Xhoxha dhe Nikoleta Marku.

### **❖ Prokurori Xhevahir LITA:**

Me funksionin Drejtues i Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, **për periudhën 01.01.2023 deri më 31.07.2023**, gjatë vitit 2023, ka përfunduar gjithsej 90 procedime penale, nga këto 90 procedime penale 1 procedim penal është transferuar, 14 procedime penale janë pezulluar, 30 procedime penale janë pushuar dhe 42 janë dërguar në gjyq.

-Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 26 kallëzime penale dhe 1 kallëzim penal është transferuar në SPAK në fazë kallëzimi.

Një volum të madh pune ka përballuar prokurori në ekzekutimin e vendimeve penale ku gjatë vitit 2023 ka nxjerrë 87 urdhra ekzekutimi, ndër të cilat 41 dënim me burg, 46 dënim me gjobë.

Ekstradime: Po kështu nga ana e këtij Prokurori është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës për 4 raste në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar, të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Letërporosi: Prokurori ka dërguar për Jashtë Shtetit 12 letërporosi dhe të ardhura nga Jashtë Shteti ka ekzekutuar 3 letërporosi.

#### ❖ **Prokurore Enkeleda HOXHA:**

Ka përfunduar hetimet për **213 procedime penale**, nga të cilat 88 procedime penale janë të mbartura nga viti i mëparshëm dhe ka përfunduar 125 procedime penale të regjistruara gjatë vitit 2023, gjithashtu kanë mbetur në hetim 17 procedime penale.

Në lidhje me procedimet pasurore hetuar me “Ligjin Antimafia”, prokurorja Enkeleda Hoxha, gjatë vitit 2023 ka patur në hetim 15 procedime pasurore nga të cilat 2 procedime pasurore i ka transferuar (1 në SPAK dhe 1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës) dhe 13 të tjera i ka në hetim.

**Gjatë vitit 2023, për procedimin pasuror nr.09/2022 prokurore Enkeleda Hoxha ka bërë 1 kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror, më datë 16.11.2023 ku me vendimin nr.176, datë 20.11.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është pranuar kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit pasuror.**

-Janë dërguar për gjykim 99 procedime penale, janë pezulluar 29 procedime penale si dhe janë pushuar 74 procedime penale, janë transferuar 11 procedime penale si dhe kanë mbatur në hetim 17 procedime penale.

-Prokurorja ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për 56 kallëzime penale si dhe ka transferuar 4 kallëzime penale në prokuroritë e tjera.

Ekstradime: Po kështu nga ana e kësaj Prokurores është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për 1 rast në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar, i cili është miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Letërporosi: Prokurorja ka dërguar 12 Letërporosi për Jashtë Shtetit dhe ka ekzekutuar nga Jashtë 3 letërporosi të ardhura nga Jashtë Shtetit.

#### ❖ **Prokurore Redona Ndoni:**

Ka përfunduar gjithsej **171 procedime penale**, dhe ka në hetim të mbartura për vitin që vjen 95 procedime penale si dhe 1 procedim pasuror.

-Prokurorja ka dërguar për gjykim 66 procedime penale, ka pezulluar 23 procedime penale, ka pushuar 49 procedime penale dhe ka transferuar 33 procedime penale.

-Ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për 51 kallëzime penale.

Ekstradime: Po kështu nga ana e kësaj Prokurore është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës për 2 raste në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar, të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Letërporosi: Prokurorja ka dërguar 12 Letërporosi për Jashtë Shtetit dhe ka ekzekutuar 3 Letërporosi të ardhura nga Jashtë Shtetit.

❖ **Prokurore Griselda Haxhijaj:**

Për periudhën 27 Korrik 2023 deri më 31.12.2023 (nga data 01.01.2023-27.07.2023 ka qenë me leje lindje) nga Prokurore Griselda Haxhijaj janë hetuar çështjet e poshtëshënuara.

-Prokurorja ka përfunduar hetimet për **24 procedime penale**, nga të cilat ka dërguar në gjyq 14 procedime penale, ka pushuar 9 procedime penale dhe ka transferuar 1 procedim penal dhe ka në fazën e hetimit 30 procedime penale. Gjithashtu ka në hetim dhe 3 procedime pasurore.

-Ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për 17 kallëzime penale.

Nga ana e prokurores Griselda Haxhijaj janë ekezkutuar 3 letërporosi të ardhura nga jasht shtetit.

❖ **Prokuror Artan Shtrungza:**

Nga data 01.05.2023 deri me datë 31.12.2023 prokuror Artan Shtrungza ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

-Prokurori ka përfunduar **162 procedime penale** të regjistruara në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Tropojë (duke përfshirë dhe procedimet penale të mbartura nga vitet e kaluara). Nga këto procedime penale prokurori ka dërguar në gjyq 38 procedime penale, ka pushuar me kërkesë për pushim në gjykatë 25 procedime penale dhe ka pushuar me vendim 34 procedime penale, ka pezulluar 58 procedime penale dhe ka transferuar 7 procedime penale.

-Prokurori ka mosfilluar 33 kallëzime penale gjatë këtij viti.

-Gjatë këtij viti ka transferuar dhe një procedim pasuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

\* Duhet përmendur fakti se prokuror **Artan Shtrungza** ka patur një ngarkesë procedimesh relativisht shumë të lartë të mbartur nga Prokuroria Tropojë, kjo për shkak se ka qenë Drejtues i Prokurorisë Tropojë nga data 01.01.2023 deri më 31.04.2023 (dhe vitin e mëparshëm 2022) dhe duke ushtruar funksionin e prokurorit njëkohësisht gjë që ka ndikuar në rritjen e ngarkesës. Shkak për ngarkesën e lartë ka qenë gjithashtu mungesa e prokurorëve në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, lëvizja së prokurorëve për shkak të pezullimeve apo transferimeve, si dhe duke ushtruar funksionin e prokurorit pa shkëputje nga shorti elektronik).

-Prokurori ka mbartur në hetim për vitin që vijon 96 procedime penale të regjistruara në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, 98 procedime penale të mbartura nga Prokuroria Tropojë, dhe 7 hetime pasurore.

Ekstradime: Po kështu nga ana e prokurorit gjatë këtij viti është bërë kërkesë për 3 raste në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar (regjistruar në

Prokurorinë Tropojë), të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Letërporosi: Prokurori ka ekzekutuar 3 letërporosi të ardhura nga jashtë shteti.

❖ **Prokurore Armida Kaçi:**

Nga data 01.05.2023 deri me datë 31.12.2023 prokurore Armida Kaçi ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

-Prokurorja ka përfunduar 69 procedime penale të regjistruara në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, nga të cilat 5 i ka transferuar, 10 procedime penale i ka pezulluar, 30 procedime penale i ka pushuar dhe 24 procedime penale i ka dërguar në gjyq.

-Gjithashtu prokurore Armida Kaçi ka përfunduar 33 procedime penale të regjistruara në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, nga të cilat 2 procedime penale i ka transferuar, 15 procedime penale i ka pezulluar, 5 procedime penale i ka pushuar dhe 11 procedime penale i ka dërguar në gjyq.


-Prokurorja ka bërë gjatë vitit 2023, 50 vendime mosfillimi procedimi penal (44 regjistruar në Prokurorinë Kukës dhe 6 regjistruar në Prokurorinë Tropojë).

-Prokurorja ka përfunduar gjithsej për vitin 2023 duke përfshirë dosjet e regjistruara gjatë këtij viti dhe ato të mbartura (69 + 33) **102 procedime penale** në total.

- Në fazën e hetimit, të mbartura për vitin 2024 prokurore Armida Kaçi ka 132 procedime penale dhe 2 hetime pasurore.

Ekstradime: Po kështu nga ana e prokurores gjatë këtij viti është bërë kërkesë për 1 rast në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar (regjistruar në Prokurorinë Tropojë), të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Letërporosi: Prokurorja ka ekzekutuar 3 letërporosi të ardhura nga jashtë shteti.



**Figura 10:** Grafiku i shpërndarjes së çështjeve sipas prokurorëve



## TREGUESIT E PUNËS PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE

Në mënyrë të përmbledhur, paraqesim ngarkesën e punës për oficerët e policisë gjyqësore.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Vladimir Shehu**, për vitin 2023 ka hetuar 117 procedime penale, ka përfunduar 106 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim 11 procedime penale.

Ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 8 procedime penale, për pushimin e hetimeve 46 procedime penale, dhe referuar për gjykim 37 procedime penale, si dhe shpallje moskompetence 4. Ka mbartur për vitin në vazhdim 11 procedime penal, 2 procedime pasurore dhe 4 procedime penale të pa regjistruar, si psh. aktet e kthyer nga Gjykata etj, me qëllim për të kryer verifikime për të kryer veprime hetimore të Prokurorëve .

Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të akteve procedurale te prodhuara nga ky OPGJ dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.

Gjithashtu ka referuar 3 kallëzime penale për vitin 2023.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Elton Hoxhaj** për vitin 2023 ka hetuar 89 procedime penale (Prokuroria Tropojë dhe Prokuroria Kukës), nga të cilat ka përfunduar hetimet për 67 procedime penale dhe ka në hetim 22 procedime penale të mbartura.

Ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 4 procedime penale, për pushimin e hetimeve 19 procedime penale, dhe referuar për gjykim 44 procedime penale. Ka mbartur për vitin në vazhdim 22 procedime penale. Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të akteve procedurale te prodhuara nga ky OPGJ dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.

Gjithashtu ka referuar 4 kallëzime penale për vitin 2023.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Krenar Lisha**, për vitin 2023, ka hetuar 93 procedime penale, ka përfunduar 68 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim 25 procedime penale.

Ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 12 procedime penale, për pushimin e hetimeve 14 procedime penale, transferuar 7 procedime penale dhe referuar për gjykim 35 procedime penale. Ka mbartur për vitin në vazhdim 25 procedime penale.

Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të akteve procedurale te prodhuara nga ky OPGJ dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.

Gjithashtu ka referuar kryesisht 1 procedim penal për vitin 2023.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Remzi Duraku**, për vitin 2023, ka hetuar 74 procedime penale, ka përfunduar 63 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim 11 procedime penale.

Ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 3 procedime penale, për pushimin e hetimeve 19 procedime penale, dhe referuar për gjykim 41 procedime penale. Ka mbartur për vitin në vazhdim 11 procedime penale.

Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të akteve procedurale te prodhuara nga ky OPGJ dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.

Gjithashtu ka referuar 3 kallëzime penale për vitin 2023.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Nikoleta Marku**, për periudhën 01.05.2023-31.12.2023 (periudha kur kam filluar detyrën si opgj), ka patur në hetim 71 procedime penale nga të cilat ka përfunduar veprimet për 47 procedime penale dhe ka në hetim 24 procedime penale.

Ka sugjeruar pushimin e hetimeve 21 procedime penale, dhe referuar për gjykim 22 procedime penale, 4 veprime hetimore për pezullim. Ka mbartur për vitin në vazhdim 24 procedime penale në fazë hetimi.

Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të akteve procedurale te prodhuara nga ky OPGJ dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.


Gjithashtu ka referuar 2 kallëzime penale për vitin 2023.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Bledar Xhoxha**, për vitin 2023, ka hetuar 76 procedime penale, ka përfunduar 55 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim 21 procedime penale, 2 (dy) procedime të hetimit pasuror dhe (dy) procedime penale të pa regjistruar, si psh. aktet e kthyera nga Gjykata etj, me qëllim për të kryer verifikime për të kryer veprime hetimore të Prokurorëve .

Ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 5 procedime penale, për pushimin e hetimeve 5 procedime penale, dhe referuar për gjykim 40 procedime penale. Ka mbartur për vitin në vazhdim 21 procedime penale.

Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të akteve procedurale te prodhuara nga ky OPGJ dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.

Gjithashtu opgj Bledar Xhoxha ka referuar me indicie 6 kallëzime penale për vitin 2023.



**Figura 11: Ngarkesa e opgj-ve për vitin 2023**

---

*TREGUESIT E PUNËS PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE TE*

*SEKSIONEVE TË DVP KUKËS*

---

Në 99% të referimeve të veprave penale nga ana e OPGj të Seksioneve që ushtrojnë veprimtarinë në Drejtorinë Vendore të Policisë dhe tre Komisariateve të Policisë Kukës, Has e Tropojë, bashkrendimi me Prokurorin e Gadshëm ka qenë tepër efikas.

Të gjitha procedimet penale të referuara janë hetuar nga Oficerët e kësaj strukture policore. Vlen të theksohet se niveli profesional në hartimin e akteve procedurale, dokumentimin e fakteve penale e administrimin e provave në hetim është jashtë pritshmërisë së organit procedues.

Gjithashtu afati i hetimit të çështjeve i përcaktuar nga Prokurori, në mënyrë permanente është shkelur në hetim dhe jo në çdo rast për arsye objektive. Mungesa e qëndrueshmërisë organike, transferimet e shpeshta, ndryshimet e emërtesës administrative brenda strukturës policore, kanë dhënë efekte negative në hetim.

Problematikë kryesore ka rezultuar, mungesa e theksuar e profesionalizmit për disa OPGJ të Komisariateve të Policisë Kukës, Has dhe Tropojë. Është evidentuar se sistemi i kontrollit të punës së OPGJ-ve nga ana e drejtuesve të strukturës së Komisarariatit Policisë ka munguar në disa raste.

Ky konstatim nuk vlen për punën e OPGJ të Seksioneve të Drejtorisë së Policisë, e cila ka reflektuar profesionalizëm, përgjegjshmëri e nivel kontrolli nga ana e Drejtuesve të saj. U ndalëm në këtë trajtim për faktin se një pjesë e hetimit procedural penal përballohet nga këta oficerë. Dështimi e sukcesi i prokurorit në hetim e gjykim është rezultat i punës së tyre. Për shkak të ngarkesës, Prokurorët jo në çdo rast kanë qenë objektivisht të mundur për të kontrolluar çdo veprim hetimor. Në këtë kontekst përgjegjshmëria, profesionalizmi dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të hetimit procedural është determinant për ushtrimin efektiv të ndjekjes penale.

Bashkëpunimi me Strukturën Policore të DVP Kukës ka qenë në nivel maksimal dhe në parametra shumë objektiv. Nga ana e Prokurorëve i është dhënë hapësira e nevojshme brenda kuadrit ligjor çdo inisiativë hetimore të OPGJ të strukturës policore. Janë pranuar kërkesat e paraqitura për hetimin proaktiv në 99% të rasteve. Por mbetet shumë për të bërë lidhur me respektimin e afateve të hetimit penal nga ana e Policisë Gjyqësore të kësaj strukture policore.

Marrëdhëniet e Prokurorisë me organet e qeverisjes vendore në nivel qarku janë zhvilluar në respektim të kuadrit ligjor e fushës së veprimitarisë së çdo institucioni, me qëllim nxitjen e rritjes së besimit të publikut tek organet e drejtësisë, duke ngritur në nivel më të lartë bashkëpunimin ndër-institucional. Ky bashkëpunim, në respektim të transparencës e pavarësisë së institucionit ka qenë e do të jetë në vijim indikator i rëndësishëm i rritjes së besimit të publikut tek institucioni.

Në përballimin e volumit të punës në Prokurorinë Kukës, një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e prokurorisë. Rezulton së gjatë vitit 2023 është punuar në përmirësimin e punës së mbajtjes së regjistrave dhe raportimeve periodike të statistikave të prokurorisë. Gjithashtu është punuar për vënien në zbatim të sistemit CAMS. Në lidhje me administrimin e prokurorisë gjatë vitit 2023, ka patur një administrim të drejtë për sa i përket zbatimit të buxhetit dhe kapaciteteve infrastrukturore të saj. Fondet e akorduara nga Prokuroria e Përgjithshme janë menaxhuar në mënyrë efikase sipas parashikimit buxhetor.

Janë krijuar marrëdhënie të besueshme me mediat dhe publikun duke dhënë informacion rreth përhapjes dhe goditjes së kriminalitetit për grup veprat penale që janë në rritje në vendin ku ushtron kompetencën territoriale kjo prokurori.

Menaxhimi i brendshëm i Prokurorisë ka qenë efikas. Ka patur rregullsi në mbajtjen e regjistrave sipas praktikës së normuar të kësaj prokurorie. Po ashtu, ka patur korrektësi në ndjekjen e disiplinës dhe etikës në punë nga punonjësit.

## **VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN DHE VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE TË PROKURORISË, SI DHE PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.**

Është synuar në zbatimin e masave të gjëra të shortit elektronik për çdo referim apo kallzim që vjen në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Shorti elektronik ka qenë shumë i rregullt dhe pa problematika, theksojmë që të gjitha materialet hetimore, referime apo kallzime shortohen elektronikisht në mënyrë të barabartë midis prokurorëve që ushtrojnë funksionin në Prokurorinë Kukës. Përjashtim nga shorti elektronik bëjnë vetëm rastet e arresteve që i kalojnë direkt prokurorit të gadshëm i cili kryen dhe hetimet paraprake, si dhe çështjet me të mitur të cilat i kalojnë direkt prokurorit të caktuar me urdhër për çështjet me të mitur (të mitur viktimë/dëshmitar dhe në konflikt me ligjin). Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është përdorur shorti manual në disa raste. Në rastet e zëvendësimit, pezullimit nga detyra apo transferimit të prokurorëve të gjitha dosjet hetimore të prokurorëve të larguar, pezulluar apo transferuar në një prokurori tjetër shortohen manualisht midis prokurorëve të tjerë, ku dosjet ndahen në mënyrë të barabartë me procesverbal-et përkatëse dhe në prani të gjithë prokurorëve midis të cilëve shortohen dosjet. Rast tjetër është për dosjet që rifillojnë hetimet apo rastet e pezullimeve kur ka zhvillime të reja hetimore dhe prokurorët e këtyre çështjeve nuk ushtrojnë më funksionin në prokurori këto dosje shortohen manualisht, apo parashkrimet të cilat shortohen manualisht në mënyrë të barabartë midis prokurorëve, si dhe letërporositë që vijnë nga jashtë shtetit, kërkesat e njohjeve të vendimeve penale të huaja shortohen manualisht dhe shoqërohen me procesverbalet përkatëse. Një kopje procesverbali mbahet në Kryesekretari, një e mban specialist i IT-së dhe një prokurori bashkë me dosjet përkatëse të rena nga shorti manual. Përjashtuar këto raste ku dosjet shortohen manualisht, për rastet e tjera është mbajtur në funksion sistemi elektronik i ndarjes dhe menaxhimit të çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), duke bërë pasqyrimin e saktë në sistem të shortit. Në lidhje me sistemin CAMS nuk ka patur problematika për ndarjen e materialeve kallëzuese. Materialet kallëzuese nga data 03.05.2023 që përkon me bashkimin e Prokurorisë Tropojë me Prokurorinë Kukës, në bazë të urdhërit nr.11 datë 03.05.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë Kukës, është bërë ndarja në seksione<sup>8</sup> dhe shorti elektronik është bërë në bazë të seksioneve.

Një vëmendje e veçantë, i është kushtuar dhe bashkimit të Prokurorisë Tropojë me Prokurorinë Kukës, e cila përveç udhëzimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme është shoqëruar me një sërë urdhrash të brendshëm të nxjerra nga drejtuesi i Prokurorisë Kukës, për mbarëvajtjen e punës. Këtu përmendim urdhërin nr.11 datë 03.05.2023 “Për ndarjen e seksioneve në Prokurorinë Kukës”, urdhrin nr.14 datë 09.05.2023 për ndryshimin e shkresave, urdhri nr. 14/1 datë 09.05.2023 në lidhje me dosjet penale të Prokurorisë Tropojë, urdhër nr.20 datë 01.06.2023 “Për riorganizimin e seksioneve”.

Sa i përket Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 03 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” për hedhjen e shortit elektronik në periudhën Janar- Dhjetor 2023, janë marrë masa për respektimin e këtij udhëzimi. Është bërë hedhja e shortit elektronik për të gjitha kallëzimet penale. Është treguar kujdes në rastet e marrjes së vendimeve për përjashtim nga shorti të

---

<sup>8</sup> Urdhri nr.11, datë 03.05.2023 “Për ndarjen e seksioneve në Prokurorinë Kukës”, i ndryshuar.

prokurorëve të caktuar, duke u nisur nga ngarkesa e tyre si dhe në rastet me raport mjekësorë. Ndërsa për çështjet e vjetra, të rifilluara, të kthyera nga gjykata dhe kur është bërë zëvendësimi i prokurorit apo heqja dorë është aplikuar shorti manual për shkak të pamundësisë së hedhjes së shortit elektronik. Në rastet e çështjeve me të mitur i janë caktuar direkt prokuores e cila merret me hetimin e çështjeve me të mitur.

Udhëzimi i Përgjithshëm nr.8/2020 datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” i ndryshuar me udhëzimin nr. 06/2021 datë 23.07.2021, ku në nenin 36 të ndryshuar të udhëzimit parashikohet raportimi periodikisht i shpenzimeve procedurale nga zyrat e financës në secilën prokurori. Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë kryer 5.344.354 lekë shpenzime në total për vitin 2023, të ndara sipas zërave përkatës. Konkretisht shpenzime për përkthyesit gjatë vitit 2023 janë në vlerën 384.454 lekë, shpenzime për avokatët 618.000 lekë, shpenzime për ekspertët 3.829.900 lekë dhe shpenzime për shërbimet e marra nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) janë në vlerën 512.000.

Udhëzimi i Përgjithshëm nr.05/2020 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës” për të siguruar konsulta teknike dhe asistencë apo këshillime mbi kërkesat e prokurorëve, për procedime apo çështje penale në fushat ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale auditimi të brendshëm publik në fushat inxhinierike – mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore, janë kryer shpenzime të ekspertizës në vlerën 3.829.900 lekë. Problematikë për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka qenë mungesa e një eksperti mjeko-ligjor dhe për këtë fakt kemi qenë të detyruar të transportojmë të dëmtuarit apo viktimën për në Institutin e Policisë Shkencore Tiranë apo dhe në morgun pranë spitalit QSUT Tiranë. Po ashtu kjo mungesë passjell që edhe aktet e ekspertimit mjekoligjor të kryhen pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, duke sjellë vonesa në përfundimin e hetimeve, për shkak të ngarkesës së punës së institutit.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe marrëdhënies së prokurorisë me publikun dhe mediat, duke zbatuar detyrimet ligjore sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Për këtë jemi angazhuar për të dhënë informacion për palët e interesuara në faqen e ëeb-it të prokurorisë në mënyrë të update-uar dhe kthimin e përgjigjeve shkresave apo kërkesave të bëra nga mediat apo palë të treta që kanë të bëjnë me çështje konkrete.

Informacioni apo të dhënat e ofruara nga ana e prokurorisë kanë qenë gjithmonë në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të dhëna që nuk çenojnë fazat hetimore të çështjeve në prokurori.

Gjatë këtij viti kemi patur 4 kërkesa për informacion në lidhje me procedime penale, për vepra të ndryshme përgjigjet e të cilave janë dhënë nga ana e prokurorisë brenda afateve kohore dhe në përputhje me ligjin nr. nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

## **VIII. Objektivat sipas drejtimeve prioritare në veprimtarinë administrative dhe funksionale të prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 dhe rekomandime.**

Objektivi kryesor për vitin 2024 është zbatimi i rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit në qarkun e Kukësit në lidhje me veprat penale me karakter ekonomik, mjedisor, korrupsionin, kondrabandën, dhunën në familje, të miturit, si dhe të gjitha çështjet me ndjeshmëri të lartë shoqërore apo me interes për publikun.

Gjithashtu kërkohet për këtë vit nxitja dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese që operojnë në Qarkun e Kukësit, si me Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, Komisariateve të Policisë Kukës, Tropojë dhe Has, me Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Shërbimin Informativ të Shtetit, me Seksionin e Sigurisë së Autostradës Milot-Morinë, me Agjencinë e Mbikqyrjes Policore, si dhe me Drejtorinë e Doganës Morinë për të patur hetime sa më efektive dhe për të luftuar kriminalitetin.

Një objektivi i rëndësishëm është rritja e ushtrimit të ndjekjes penale duke përdorur metoda speciale të hetimit, siç janë metodat proaktive të hetimit, ngritja e grupeve operationale dhe hetimore në terren, përdorimi i mjeteve teknologjike aty ku është e nevojshme për të minimizuar veprat penale pa autor, kryesisht për veprën penale të “Kultivimit të narkotikëve” që gjatë këtij viti ka patur një rritje relativisht të lartë krahasuar me vitet e mëparshme.

Një detyrë për tu realizuar mbetet rritja e besimit tek publiku, pasi të gjithë indikatorët flasin për një nivel jo të kënaqshëm që kanë qytetarët në drejtësinë penale, ku bën pjesë edhe prokuroria. Për këtë, synojmë që jo vetëm shpejtësia dhe cilësia e hetimit, por edhe transparenca ndaj publikut do të ndikojë për të sjellë një rritje të besimit e për rrjedhojë edhe të bashkëpunimit me ne. Shtimi i informacioneve dhe kthimi i përgjigjeve në kohë drejt personave që kërkojnë informacion nga prokuroria brenda afatit të arsyeshëm dhe me të dhënat e duhura do të shtojë transparencën e këtij institucioni. Çdo prokuror duhet të shfaqë dhe të dëshmojë detyrimin ndaj qytetarëve që me profesionin e tij të japë drejtësi penale të pavarur dhe të pandikuar nga faktorët e jashtëm.

Një pikë e rëndësishme është konstatimi i faktit të rritjes së ngarkesës së prokurorisë efektive të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës gjatë vitit 2023, shkak për këtë janë transferimet, pezullimet, pritja e vendimeve të KPA-së për disa prokurorë që janë akoma në organikë por nuk ushtrojnë funksionin e prokurorit. Për këtë shkak është i nevojshëm që nga KLP të kryhet plotësimi i organikës me prokurorë.

Është e rëndësishme që nga Prokuroria e Përgjithshme të sigurohet mundësia për garantimin e kuadrit kontraktor për ruajtjen e prokurorisë me SHRSF pas orarit zyrtar të punës dhe në ditët e pushimit zyrtar.

Angazhohemi në rritjen e komunikimit me mediat lokale e qendrore në tërësi duke respektuar sekretin hetimor, si dhe duke mbrojtuar të dhënat personale duke informuar periodikisht në lidhje me punën e prokurorisë, si dhe me rezultatet dhe arritjet apo problematikat që dalin në vijimësi të punës sonë.

Informimi i medias dhe i publikut në tërësi, për punën e prokurorisë, si dhe në lidhje me shqetësimet dhe për çështjet sensitive që janë objekt i punës së prokurorisë vlerësojmë se do të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e besimit dhe në përmirësimin e imazhit të Prokurorisë.

Për Vitin 2024 mbetet prioritet thelbësor përfundimi në kohë të shpejtë i procedimeve penale të mbartura, rritja e shkallës së efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale nëpërmjet hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e doganave, në fushën e lëndëve narkotike e trafiqeve të paligjshme, krimit kufitar, në fushën e krimit ekonomik, rritja e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit si dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese në Qark.



Shkurt 2024